

Miftar KURTI

**JETA DHE VEPRIMTARIA E USHTARAKUT
PROFESIONIST, KOMANDANTIT DHE HEROIT
TË KOSOVËS SHEMSI AHMETI (8 qershor 1969-26 prill 1999)**

Disa fjalë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës

Ushtria Çlirimtare Kosovës pati në radhën e veta ushtarakë profesionistë, komandantë e personalitete të shquara, që me përkushtimin, guximin, profesionalizmin dhe sakrificën e tyre sublime ngritën në nivelin më të lartë imazhin e UÇK-së, i dhanë përmasë kombëtare e ndërkombëtare luftës për liri e pavarësi. Njëri prej tyre është Shemsi (Arif) Ahmeti (8 qershor 1969-26 prill 1999) nga fshati Kodër (ish-Zasellë) i Komunës së Mitrovicës. Ai ishte ushtarak profesionist me Akademi të Lartë të Artilerisë të përfunduar në ish-Armatën Popullore të Jugosllavisë (APJ), ishte komandant i Kompanisë së Artilerisë në APJ dhe pjesëmarrës në luftën Serbi-Kroaci. Gjatë luftës së UÇK-së, në zonën e përgjegjësisë të Zonës Operative të Shalës (ZOSH), ka kryer detyrat e komandantit të Kompanisë në Batalionin II të Brigadës 141 “Mehë Uka”, të komandantit të Njesisë Speciale, të Njësitit të Artilerisë dhe komandantit të Kazermës më të madhe të UÇK-së në fshatin Bare. Ka themeluar njësite ushtarake, ka ndikuar në organizimin, riorganizimin dhe komandimin e tyre në disa nga betejat kryesore. Për heroizmin e treguar gjatë luftës për liri është dekoruar nga Presidenca e Kosovës me Urdhrin “Hero i Kosovës” dhe është graduar (postmortum) nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së me gradën e Kolonelit. Me punën, përkushtimin, profesionalizmin dhe sakrificën sublime kontribuoi që viti i fundit i dekadës së fundit të shekullit XX ta gjejë Kosovën të çliruar nga robëria. Kjo përbën fokusin e këtij punimi.

Dekada e fundit e shekullit XX Kosovën e gjeti si mos më keq, pothuajse identike me dekadën e parë të atij shekulli.¹ Mirëpo, gjysma e dytë e vitit të fundit të dekadës së fundit të shekullit që lamë pas, e gjeti Kosovën në

¹ Oliver Jens Schmit, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012. f. 134; Agim Vinca, “Viti 1913-vit i kujtesës”, Koha ditore, 9 shkurt 2013, f. 26.

liri, duke iu falënderuar në mënyrë të veçantë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), dëshmorëve të saj, njëri prej të cilëve është Shemsi Ahmeti. Pa e mohuar luftën dhe sakrificën shekullore të popullit, rolin e protestave dhe demonstratave 1989-1990, grevën e minatorëve të Minierës “Trepça” në Stantërg (20-28 shkurt 1989), formimin e LDK-së (23 dhjetor 1989), Deklaratën Kushtetuese për Kosovën si njësi e pavarur dhe e barabartë në kuadër të Federatës-Konfederatës së Jugosllavisë (2 korrik 1990), Kushtetutën e Kaçanikut (7 shtator 1990)², funksionimin e sistemit (paralel) të arsimimit të pavarur në gjuhën shqipe³ dhe të shëndetësisë⁴, si dhe përpjekjet për organizim dhe riorganizim të organizatave të fshehta, si LPK-ja⁵, LKÇK-ja⁶, etj., vetëm pas formimit të UÇK-së (17 nëntor 1994)⁷ dhe veprimtarisë së saj luftarake, çështja e Kosovës mori rrugën e zgjidhjes, lirisë dhe pavarësisë.

Meqë Kosova nuk u përfshi as në bisedimet e as në Marrëveshjen e Dejtonit (1995), shqiptarët u detyruan të ndërrojnë qasjen dhe mënyrën e veprimit karshi dhunës e terrorit serb në vitet ‘90. Në vitin 1996, UÇK-ja filloi t’i sulmojë forcat policore dhe ushtarake serbe, të cilat ushtronin dhunë dhe terror në Kosovë. Sulmet e UÇK-së po ndodhnin disa muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit⁸. Me daljen e saj publike, më 28 nëntor 1997, në fshatin Llaushë të Drenicës, në varrimin e mësuesit Halit Geci, i vrarë nga forcat serbe, UÇK-ja u bë shpresa e popullit të Kosovës.⁹ Vetëm shfaqja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kërcënimi nga përshkallëzimi i dhunës e detyruan bashkësinë ndërkombëtare që të merrej me krizën e Kosovës më me vendosmëri. Rolin udhëheqës, si dhe në rastet e tjera kur bashkësia ndërkom-

² Akademia e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi V, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2023, f. 680, 681.

³ Bajram Shatri, *Arsimi shqip në Kosovë 1990-1999*, Libri shkollor, Prishtinë, 2010.

⁴ Gani Demolli, *Një luftë më ndryshe: kushtuar shërbimit shëndetësor të SHHB “Nëna Terezë”*, Koha, Prishtinë, 2007.

⁵ Sejdi Gega & Fazli Veliu, *LPK-UÇK*, Arbëria Desing & SHVLUÇK, Tetovë, 2018; Sabile Keçmezi-Basha, *Organizatave dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2003.

⁶ Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, *Misioni i Çlirimit* (korrik 1993-shkurt 1996), I, Eurolindja, Tiranë, 1998; Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, *Misioni i Çlirimit* (mars 1996-gusht 1998), II, Eurolindja, Tiranë, 1998.

⁷ Sejdi Gega & Fazli Veliu, *LPK-UÇK*, Arbëria Desing & SHVLUÇK, Tetovë, 2018.

⁸ Misha Glenny, *Historia e Ballkanit 1804-1999* (përktheu: Abdurrahim Myftiu), Instituti i Dialogut & Komunikimit, Botimet Toena, Tiranë, 2007, f. 653.

⁹ Shaban Sinani, *Kosova në gjeopolitikë*, Botimet Dritëro, Tiranë, 1998, f. 239.

bëtare përballej me sfida serioze, e mori përsipër SHBA-ja.¹⁰ Kësisoj, u krijua një situatë krejtësisht e re, e cila bëri që komuniteti ndërkombëtar të fillojë të interesohet më shumë dhe të reagojë. Sipas analistit ushtarak në Pentagon, Anthony H. Cordesman, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Bashkimi Evropian (BE), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Grupi i Kontaktit (Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Britania e Madhe dhe SHBA) filluan ta trajtojnë situatën në Kosovë si një krizë të mundshme.¹¹

Lufta e UÇK-së mori përmasë kombëtare¹² dhe ndërkombëtare¹³, sepse ishte njëra prej kryengritjeve më të suksesshme të periudhës pas Luftës së Ftohtë, që ilustronte zenitin në shekullin njëzet të “Luftës së Gjeneratës së Katërt” apo “4GW”^{14*}. UÇK-ja është vlerësuar si lëvizja e parë kryengritëse e suksesshme që nga Lufta e Dytë Botërore, është vlerësuar si jashtëzakonisht novatore dhe si kryengritja e parë postmoderne¹⁵. Vlerësimi dhe cilësimi i UÇK-së nga kancelaritë perëndimore pati një evolucion interesant, duke filluar nga “forca ekstremiste” në “forca çlirimtare”.¹⁶ CIA amerikane (Central Intelligence Agency), që në takimin e parë me përfaqësuesit e UÇK-së, në muajin shkurt 1998, i cilësonte pjesëtarët e saj si çlirimtarë¹⁷. Zyrtarët e NATO-s, sidomos gjatë Operacionit “Forca Aleate” (24 mars-20 qershor 1999) kundër Republikës Federative të Jugosllavisë së Sllobodan Millosheviçit, i

¹⁰ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, f. 91-94, 101, 132, 133, 141, 146, 148.

¹¹ Anthony H. Cordesman, *The Lessons and Non-Lessons of the Air and Missile Campaign in Kosovo*, Revised August, 2000, f. 6-7 (https://csis-website-prod.s3.amazonaws.com/s3fs-public/legacy_files/files/media/csis/pubs/kosovolessons-full.pdf, qasja 18. 08. 2022).

¹² Emin Kabashi, “Përmasa kombëtare e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-vlerë kombëtare*, Intituti Albanologjik-Prishtinë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2022, f. 81-86.

¹³ Fehmi Baftiu, *Kosova krizë ndërkombëtare*, Çlirimi, Prishtinë, 2011.

^{14*} Ky term nënkupton integrimin e aspekteve politike dhe ushtarake të luftës (Henry H. Perritt Jr., *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-rrëfim prej brenda për një kryengritje*, Koha, Prishtinë, shtator 2008, f. 8).

¹⁵ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Onufri, Tiranë, 2013, kopertina e librit.

¹⁶ Ksenofon Krisafi, *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, UMSH Press & Onufri, Tiranë, 2018, f. 117.

¹⁷ Blendi Fevziu, Intervistë me Fatos Klosin ish-shef i Shërbimit Informativ Shtetëror, TV Klan, 5 nëntor 2025.

janë referuar si Ushtria Çlirimtare e Kosovës¹⁸, ashtu siç kanë vepruar edhe Sekretarja e Shtetit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Madeleine Albright¹⁹, Lordi George Robertson, ish-ministri i Mbrojtjes i Britanisë dhe ish-Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s²⁰, si dhe historianë, diplomatë e ushtarakë, si R. Craig Nation²¹, Henry H. Perritt Jr.²², James Pettifer²³, Benjamin S. Lambeth²⁴, Dario Malnar²⁵, Anthony H. Cordesman²⁶, Daniele Ganser²⁷ dhe shumë të tjerë.

Në Kosovë nuk do të kishte UÇK, po të mos ua kishin mohuar të drejtat kosovarëve (shqiptarëve-M. K.), shkruan Sekretarja e Shtetit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Madeleine Albright.²⁸ Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) doli si rezultat i represionit të Serbisë në Kosovë – ka deklaruar në vitin 2000, Lordi George Robertson, ish-Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s.²⁹ Ndërkaq, historiani R. Craig Nation shkruan se Ushtria Çlirimtare e Kosovës doli nga krahu i lëvizjes kombëtare të Kosovës si qendër e rezistencës aktive, kurse ngritja e UÇK-së, sipas tij, është produkt i zhgënjimit të grumbulluar.³⁰ E vërteta e madhe është se rruga drejt pavarësisë së Kosovës

¹⁸ Miftar Kurti, *NATO për Kosovën (24 mars-20 qershor 1999)*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2024.

¹⁹ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Botimet Dudaj, 2004, f. 445.

²⁰ Lord Robertson of Port Ellen Secretary General of NATO, Kosovo one year on Achievement and Challenge, f. 6. (https://archives.nato.int/uploads/r/null/1/3/137989/0346_Kosovo_one_year_on-Achievement_and_Challenge_2000_ENG.pdf), qasja 18. 08. 2022).

²¹ R. Craig Nation, *War in the Balkans, 1991-2002*, August 2003, f. 226 (https://www.files.ethz.ch/isn/101059/War_Balkans.pdf, qasja e fundit 9. 09. 2024).

²² Henry H. Perritt Jr., *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-rrëfim prej brenda për një kryengritje*, Koha, Prishtinë, shtator 2008.

²³ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Onufri, Tiranë, 2013.

²⁴ Benjamin S. Lambeth, *NATO's Air War for Kosovo: A Strategic and Operational Assessment*. Santa Monica, CA: Rand Corporation, 2001.

²⁵ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013.

²⁶ Anthony H. Cordesman, *The Lessons and Non-Lessons of the Air and Missile Campaign in Kosovo*, Revised August, 2000, f. 6-7 https://csis-website-prod.s3.amazonaws.com/s3fs-public/legacy_files/files/media/csis/pubs/kosovolessons-full.pdf, qasja 18. 08. 2022).

²⁷ Daniele Ganser, *Gladio shërbimi sekret i NATO-s 1949-2001* (shqipëruar nga Ilir Krasniqi), Helga's Secrets, pa vit botimi, f.105, 107.

²⁸ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Botimet Dudaj, 2004, f. 445.

²⁹ Lord Robertson of Port Ellen Secretary General of NATO, Kosovo one year on Achievement and Challenge, f. 6. (https://archives.nato.int/uploads/r/null/1/3/137989/0346_Kosovo_one_year_on-Achievement_and_Challenge_2000_ENG.pdf), qasja 18. 08. 2022).

³⁰ R. Craig Nation, *War in the Balkans, 1991-2002*, August 2003, f. 226 (https://www.files.ethz.ch/isn/101059/War_Balkans.pdf), qasja e fundit 9. 09. 2024).

mund të ishte e gjatë dhe e pashpresë, nëse nuk do të lindte UÇK-ja dhe të provokonte ndërhyrjen ndërkombëtare të NATO-s.³¹

Nëse takimi i parë i përfaqësuesve të UÇK-së me CIA-n amerikane ndodhi në muajin shkurt 1998³², atëherë nga vera e atij viti, UÇK-ja është pranuar nga SHBA-ja si subjekt i përpjekjeve politike për të zgjidhur krizën.³³ Beretat e Gjelbra amerikane stërvitën dhe pajisën në mënyrë të fshehtë forcat e UÇK-së para dhe gjatë Operacionit “Forca Aleate” në vitin 1999. Edhe britanikët, si edhe amerikanët, francezët dhe gjermanët, përveç se patën takime, ata ndihmuan UÇK-në. Më konkretisht, njësitë e SAS-it britanik ishin përfshirë në luftën e Kosovës dhe e kishin stërvitur dhe pajisur në mënyra të fshehta UÇK-në gjatë OFA-s (Operacionit “Forca Aleate”), ashtu ai edhe amerikanët.³⁴ Janë publikuar të dhëna se UÇK-ja mbështetej në mënyrë të fshehtë edhe nga francezët, konkretisht nga Presidenti Jacques Chirac dhe ministri i Mbrojtjes, Alain Richard³⁵, ashtu siç janë publikuar të dhëna se ky i fundit e akuzonte atë si faktor destabiliteti.³⁶ Disa segmente të Qeverisë Gjermane e mbështesnin UÇK-në dhe idenë e një rezistence të armatosur në Kosovë shumë kohë para se këtë ta bënte SHBA-ja, Britania apo Franca. Shërbimet gjermane të inteligjencës raportohet se stërvitën dhe ndihmuan në financimin e UÇK-së, duke u përballur me kritikën e SHBA-së, e cila favorizonte një strategji më të matur deri në vitin 1998.³⁷

UÇK-ja ka kaluar nëpër katër faza të krijimit dhe zhvillimit të saj: Faza e parë (1981-1990), faza e dytë (pranverë 1991-shkurt 1998), faza e tretë (mars 1998-shtator 1998) dhe faza e katërt (tetor 1998-qershor 1999).³⁸ Në këtë kontekst UÇK-ja ka kaluar edhe nëpër disa perioda (periudha) ose nënfaza të veprimtarisë së saj.³⁹ Komandanti i Përgjithshëm i UÇK-së ishte Azem

ethz.ch/isn/101059/War_Balkans.pdf, qasja e fundit 9. 09. 2024).

³¹ Mero Baze, *Republika e parë*, Uetpress, Tiranë, pvb, f. 15.

³² Blendi Fevziu, Intervistë me Fatos Klosin ish-shef i Shërbimit Informativ Shtetëror, TV Klan, 5 nëntor 2025

³³ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, f. 152, 153.

³⁴ Daniele Ganser, *Gladio shërbimi sekret i NATO-s 1949-2001* (shqipëruar nga Ilir Krasniqi), Helga's Secrets, pa vit botimi, f.105, 107.

³⁵ Jacques Baudouin 2018: 14, 203

³⁶ Fehmi Baftiu, *Kosova krizë ndërkombëtare*, Çlirimi, Prishtinë, 2011, f. 201, 281, 286, 287.

³⁷ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Onufri, Tiranë, 2013, f. 186, 190.

³⁸ Akademai e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar (3)*, Tiranë, 2009, f. 2826, 2827, 2828.

³⁹ Emrush Xhemajli, “Periodizimi i krijimit dhe i zhvillimit të Ushtrisë Çlirimtare të

Syla. UÇK-ja kishte në përbërje të saj 7 Zona Operative: Zona Operative e Drenicës, Zona Operative e Pashtrikut, Zona Operative e Dukagjinit, Zona Operative e Shalës, Zona Operative e Llapit, Zona Operative e Nerodimes dhe Zona Operative e Karadakut.⁴⁰

Zona Operative e Shalës dhe njësitë e saj vartëse

Historia e luftës dhe veprimtarisë së UÇK-së do të mbetet shumë e mangët pa veprimtarinë e saj në veriun e Kosovës (Mitrovicë, Vushtrri dhe krahinën e Shalës së Bajgorës). Në këtë pjesë të Kosovës ka vepruar Zona Operative e Shalës (ZOSH). Ashtu siç janë përgatitur disertacione, botuar libra të ndryshëm dhe artikuj të shumtë nëpër gazeta e revista kombëtare e ndërkombëtare për UÇK-në, po ashtu janë shkruar disertacione⁴¹, janë botuar libra⁴², punime (artikuj, kumtesa, vështrime, trajtesa) në gazeta dhe revista, si dhe janë publikuar dokumentarë televiziv për Zonën Operative të Shalës dhe dëshmorët e saj. Referuar këtyre burimeve, por jo vetëm, del se organizmi i UÇK-së në rajonin e Shalës fillon me themelimin e “Grupit të Drenicës” dhe vetë UÇK-së. Rrahman Rama⁴³, Ali Januzi⁴⁴, Idriz Asllani dhe Ramadan Monovi⁴⁵ janë ndër të parët që kontribuuan për formimin, masivizimin dhe shtrirjen e UÇK-

Kosovës”, *Kosova 1989-1999: Organizimi dhe qëndresa për çlirim*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2025, f. 159-167.

⁴⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (3)..., f. 2829, 2830.

⁴¹ Miftar Kurti, *Veprimtaria luftarake e Zonës Operative të Shalës (1998-1999)*, Departamenti i Historisë i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

⁴² Gani N. Lahu, *Rrezet e lirisë, Vushtrri*, 2023; Emin Kabashi, *Komandanti i lirisë, Era, Prishtinë*, 2010; Dritë Simnica, *Heroizmi i kreshtave të Shalës, Ditar luftime, Prishtinë, Vatra*, 2000; Jakup Ceraja, *Ditari i rrethimit, Prishtinë, Rilindja*, 1999; Asllan Istrefi, *Vjen me gjoksore vrima-vrime, Mitrovicë*, 2016; Riza Greiçevci, *Gjergji i maleve të Shalës, Prishtinë, botim i autorit*, 2004; Bedri Tahiri, *Flakadanët e lirisë, Vatra*, 2004; Bedri Tahiri, *Flakadani i lirisë, N. SH Armagedoni, Prishtinë*, 2023; Jahë Hajdar Januzi, *Kujtimet e mia nga burgjet, Zurich, botimi i autorit*, 2012.

⁴³ Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës*, Prishtinë, 2018.

⁴⁴ Fakte me Adnan Merovcin: Ali Januzi, jeta dhe vepra, Pjesa 1-2 (https://www.youtube.com/watch?v=aC14s_ytZ5g, qasja e fundit 25. 08. 2025); Ali Januzi n’DEMOS-Një jetë kushtuar çështjes kombëtare (<https://www.youtube.com/watch?v=QvlsbR0uZII>, qasja e fundit 25. 08. 2025)

⁴⁵ Ali Januzi, Idriz Asllani dhe Ramadan Manovi nderohen nga Komuna e Vushtrrisë me çmimin “Hasan Prishtina”, RTK (<https://www.youtube.com/watch?v=8xiQGg73ASg>, qasja e fundit 25.08.2025).

së në Vushtri, Mitrovicë e fshatrat e Shalës së Bajgorës. Idriz Asllani dhe Ali Jonuzi, të ngarkuar ndër të tjera edhe me akuzën se e kanë formuar UÇK-në, më 11 korrik 1997, dënohen me nga 15 vjet burg (i fundit dënohet në mungesë).⁴⁶ Kontribut të veçantë në trasimin e rrugës për fillimin e luftës çlirimtare në rajoni i Mitrovicës, Vushtrrisë, Shalës së Bajgorës dhe në gjithë Kosovën, me veprimet e tyre politike dhe ilegale (të fshehta) kanë dhënë Raif Qela, Sabit Veseli, Kadri Veseli, Mehë Uka, Gani Baliu, Mehmet Hajrizi, Naser Hajrizi, Xhavit Haziri, Ramadan Pllana, etj., mirëpo më meritori, konkretisht për formimin e nënzonës, më pas të Zonës Operative të Shalës është Rrahman Rama.

Zona Operative e Shalës (ZOSH) shtrihej nga fshatrat Kaçanoll (në lindje) dhe Selac (në veri) të krahinës së Shalës së Bajgorës deri në Qyqavicë (në perëndim). Kjo Zonë kufizohej me Zonën Operative të Drenicës dhe Zonën Operative të Llapit. Formimi i Zonës Operative të Shalës (fillimisht si nënzonë) u bë më 28 qershor 1998. Komandant i ZOSH-it nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së u emërua Rrahman Rama.⁴⁷ Dy ditë pas formimit të Nënzonës Operative të Shalës, më 30 qershor, formohet Brigada 141 “Mehë Uka” e ZOSH-it, në krye me komandantin Hysni Ahmeti⁴⁸, e cila pasohet nga Brigada 142 e ZOSH-it, e komanduar nga komandanti Enver Oruçi.⁴⁹ Shtabi i Zonës ishte në Ashlan. Zona Operative e Shalës kishte këtë përbërje dhe strukturë: Rrahman Rama - komandant, Mensur Kosumi - zëvendëskomandant, Drita Simnica - ndihmëskomandante për Çështje Personale, Sabit Gashi - nd. komandant për Informim, Bahri Nuredini - nd. komandant për Financa, Ilaz Bejtullahu nd. komandant për Ndërlidhje, Xhevat Jusufi - nd. komandant për Logjistikë, Ali Jonuzi - nd. komandant për Moral dhe Politikë, Isa Hajrizi - komandant i Policisë Ushtarake, kurse Bekim Shyti ishte komandant i Njësisë Speciale.⁵⁰

Brigada 141 ishte njësi vartëse e Zonës Operative të Shalës, e cila u formua në fshatin Bare (komuna e Mitrovicës), në shtëpinë e Ismet Feratit, më 30 qershor 1998.⁵¹ Ishte njësi tipike ushtarake e organizuar në batalione,

⁴⁶ Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Dokumente dhe artikuj, Zëri i Kosovës, 1998, f. 165.

⁴⁷ Hysni Sylja, Intervistë me komandantin e ZOSH, Rrahman Rama, RTV Mitrovica, 2010.

⁴⁸ Miftar Kurti, Intervistë me Hysni Ahmetin-komandantin e Brigadës 141, Mitrovicë, qershor 2013.

⁴⁹ Intervistë me Enver Oruçin-komandant i Brigadës 142, qershor-korrik 2020.

⁵⁰ Arkivi i TMK-së i Zonës IV Mbrojtës, Struktura e ZOSH, Mitrovicë, 2001.

⁵¹ Ushtria Çlirimtar e Kosovës, Brigada 141 “Mehë Uka”, Vendim nr. 1, 30. 06. 1998, Arkivi i Brigadës; Ajet Bajrami, Procesverbal, datë 30. 06. 1998, Bare.

kompani, togje, skuadra e deri në grup⁵². Kjo brigadë kishte zonën e saj të përgjegjësisë, e cila kishte shtrirje në fshatrat e komunave: Mitrovicë, Vushtrri dhe Albanik (Leposaviq).⁵³ Territori i Brigadës 141 në lindje kufizohej me Zonën Operative të Llapit, më saktë, vijë ndarëse ishte Kërshi i Bardhë-Potoku, Kodra e Kaçanollit-Kobillaçi-Lugu i Lupçës-Javori i Rrëzhanës; në veri: kufiri verior me Serbinë, më saktë, përtej fshatit Selac, i cili kufizohet me fshatin Bërçan të banuar me serbë; në perëndim shtrihej përgjatë lumit Sitnica, që ndante zonën e përgjegjësisë së Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës; në jug si vijë kufitare ishin fshatrat Brezhticë, Kozernicë dhe Popovë.⁵⁴ Komandant i brigadës ishte Hysni Ahmeti, ndërsa zëvendëskomandant Zymer Halimi (Besi). Brigada kishte katër batalione: komandant i Batalionit I ishte Hajzer Istrefi, komandant i Batalionit II ishte Ajat Bajrami, komandant i Batalionit III ishte Hasan Preteni, kurse komandant i Batalionit IV ishte Gani Imeri. Shtabi i Brigadës kishte gjashtë sektorë: Sektorin e Personelit, shef i të cilit ishte Emin Musa; Shef i Zbulim Kundër Zbulim (ZKZ) ishte Raif Preteni; i Operativës - Feriz Fetahu; i Logjistikës -Behxhet Bala; për Moral dhe Politikë - Ali Januzi dhe Emin Begu; i Ndërlidhjes - Nexhat Dedia. Në kuadër të Brigadës kanë funksionuar edhe Shërbimi Mjekësor Sanitar, i cili është udhëhequr nga Rustem Musa dhe Agim Sherifi; Shërbimi për Planifikim dhe Financa, të cilin e kanë udhëhequr Dibran Përçuku, Skender Hajdari dhe Niman Fejza (ky i fundit vetëm deri më 15 shtator 1998); Shërbimi për Mirëmbajtje dhe Veshmbathje, i udhëhequr nga Ramiz Osmani dhe Hamit Muja.⁵⁵ Brigada në përbërje të vet kishte dhe dy njësi: Njësinë për Intervetime të Shpejta, komandant i së cilës ishte Rexhep Suma⁵⁶ dhe Njësinë Speciale, komandant i së cilës ishte Shemsi Ahmeti.

⁵² Dokumentar për jetën dhe veprën e Dëshmorit Rustem Hyseni (Historian), producent Armond Morina, regjia dhe montazhi Blerta Basholli, Morina Films, qershor 2012 (<https://www.youtube.com/watch?v=sV-Vxvuy1Y>, qasja e fundit 23. 05. 2025).

⁵³ Kolonel Hysni Ahmeti (sh-komandant i Brigadës 141 “Mehë Uka”), Dokumentar, RTK, qershor, 2012.

⁵⁴ Dokumentar për jetën dhe veprën e Dëshmorit Rustem Hyseni (Historian), producent Armond Morina, regjia dhe montazhi Blerta Basholli, Morina Films, qershor 2012 (<https://www.youtube.com/watch?v=sV-Vxvuy1Y>, qasja e fundit 23. 05. 2025).

⁵⁵ Arkivi i TMK-së i ZIVM-Mitrovicë, Struktura e Brigadës 141 “Mehë Uka”; Miftar Kurti, Brigada 141 “Mehë Uka” e ZOSH, Punim Masteri, korrik 2013; Miftar Kurti, Intervistë me Intervistë me Dr. Rustem Musën- shefi i Shërbimit Sanitar të Brigadës 141, maj 2020; Intervistë me Agim Sherifin-Shërbimi Sanitar i Brigadës 141, maj 2020.

⁵⁶ Miftar Kurti, Bisedë me Rexhep Sumën, Mitrovicë, 22 dhjetor 2012.

Formimi i Njesisë Speciale

Njësia Speciale u formua në fshatin Bajgorë në fund të muajit shtator 1998, në rrethana tepër të vështira, atëherë kur Brigada ishte në prag të shpartallimit për shkak të “Ofensivës së shtatorit” 1998, të cilën e ndërmoren forcat ushtarake, policore dhe paramilitare të Jugosllavisë së Millosheviqit. Ideator, themelues dhe komandant i parë i Njesisë Speciale ishte Zymer Halimi (Komandant Besi). Stërviçet e kësaj njësie, të cilat, në periudhën kohore tetor-dhjetor 1998 i udhëhoqi Zymer Halimi, filluan më 1 tetor 1998 në shkollën-kazermë në Bajgorë. Në Njësinë Speciale u inkuadruan pjesëtarë të moshës së re, por të sprovuar në vija fronti. Në strukturën e saj kishte kuadër të profileve të ndryshme. Me akademi ushtarake (Zymer Halimi e Shemsi Ahmeti), mësimdhënës, absolventë dhe studentë të filologjisë, filozofisë, historisë, ekonomisë, gjeoshkencave, por edhe sportistë të dalluar, duke përfshirë edhe kampionë të Kosovës në karate. Njësia Speciale, fillimisht, kishte formatin e një toge, që përbëhej nga tri skuadra dhe kishte 34 ushtarë.⁵⁷ Stërviçet e Togës së Parë të Njesisë Speciale, sipas gjeneralit Zymer Halimi, janë realizuar me një plan të përgatitur mirë në këto fusha: Taktikë e përgjithshme, taktikë speciale, përdorim i të gjitha llojeve të armatimit në dispozicion, topografi dhe përgatitje moralo-politike.⁵⁸ Kushtet e stërviçeve ishin tepër të vështira. Jo të gjithë arritën t’i përballojnë stërviçet dhe t’i përfundojnë me sukses. Nëntori shënoi fundin e stërviçeve intensive të Togës së Parë, pas të cilës u formuan Toga e Dytë dhe Toga e Tretë e Njesisë Speciale. Pas një kohe, Njësia Speciale transferohet nga shkolla-kazermë në fshatin Bajgorë në shkollën-kazermë në fshatin Bare.

⁵⁷ Pjesëtarë të Togës së Parë të Njesisë Speciale, ditën e themelimit dhe fillimit të stërviçeve, sipas Ndhimëskomandantit për Çështje Personale në Brigadën 141, Emin Musa, ishin: Afrim Jakup Murseli, Agron Xhavit Sylja, Ahmet Shaqir Menxhiqi, Arsim Ferat Musa, Arsim Nazmi Muzaqi, Bahri Ali Hyseni, Bajram Dibran Peci, Baki Bajram Peci, Basri Eshref Fazliu, Behxhet Ali Istrefi, Bekim Nezir Islami, Enver Istref Musa, Eset Xhafer Ibishi, Faruk Nazmi Beqiri, Fehmi Rasim Bunjaku, Ferit Vesel Preteni, Hajzer Mehmet Kurti, Miftar Mehmet Kurti, Hamzë Shefit Behrami, Ilaz Ismajl Berisha, Levent Hetem Gara, Lutfi Ilaz Bunjaku, Mirsad Jashar Nimani, Musli Bali Musa, Mustafë Kadri Ibishi, Musë Rrahim Musa, Nysert Osman Musa, Rrahman Ahmet Latifi, Rrustem Shefqet Rrustemi, Sejdi Sadik Fejzullahu, Shefqet Idriz Kurti, Shefqet Lutfi Begu, Shukri Beqir Selimi dhe Vesel Jashar Murseli (Emin Musa-Ndhimëskomandant për Çështje Personale në Brigadën 141 “Mehë Uka”, Lista emërore e Njesisë Speciale në ditën e themelimit, Shënim, Bajgorë, shtator 1998).

⁵⁸ Riza Graicevci, *Gjergji i maleve të Shalës*, Botues Familja Beqiri, Prishtinë, 2004, f. 40.

Rënia e Xhevat Jusufit dhe plagosja rëndë e Zymer Halimit-Besit, më 3 janar 1999, në hyrje të fshatit Smrekonicë të Komunës së Vushtrrisë, ndryshoi shumëçka. Komanda veproi shpejt dhe emëroi komandant të Njësisë Speciale Shemi Ahmetin, i njohur si Komandant Shemi.

Jeta, shkollimi dhe veprimtaria e ushtarakut Shemi Ahmeti para Luftës së UÇK-së

Për dëshmorët e Zonës Operative të Shalës dhe veprimtarinë luftarake janë botuar libra, janë shkruar artikuj, janë përgatitur dokumentarë, janë publikuar dhe vepra të artit figurativ (skulpturë dhe pikturë). Libra, artikuj të ndryshëm, poezi, këngë e dokumentarë, vepra arti në pikturë e skulpturë, janë përgatitur edhe për komandantin dhe Heroin e Kosovës, Shemi Ahmeti, të cilat janë përdorur si referenca në këtë punim, por pa lënë anash dokumentet arkivore dhe rrëfimet e bashkëluftëtarëve.

Shemi (Arif) Ahmeti lindi më 8 qershor 1969 në fshatin Kodër (ish-Zasellë), në Komunën e Mitrovicës.⁵⁹ Shkollën fillore e nisi në fshatin e tij të lindjes, ndërsa e përfundoi në fshatin Shupkoc të Komunës së Mitrovicës. Në vitin 1984 u regjistrua në Gjimnazin Ushtarak, në Beograd (Serbi), në drejtimin e përgjithshëm, ndërsa e vazhdoi dhe e përfundoi në Sarajevë (Bosnjë dhe Hercegovinë). Ishte njëri ndër kadetët më të mirë të gjeneratës, gjë që ia bëri të mundur që të regjistrohej pa vështirësi në Akademinë e Lartë të Artilerisë në Zarë të Kroacisë, ku u dallua për zgjuarsinë e jashtëzakonshme. Zgjuarsia dhe përkatësia kombëtare shqiptare sikur kishin zgjuar dozë urrejtjeje dhe xhelozie tek eprorët e tij, sidomos tek ata serbë, të cilët me qëllim të ndërprerjes së vrullit të studimeve, e dërgojnë në efektivat e artilerisë në Smederevska Pallankë (Serbi) dhe në Vërshac të Krahinës Autonome të Vojvodinës (Jugosllavi)⁶⁰. Dërgimi në efektivat e artilerisë së “Armatës Popullore të Jugosllavisë” (APJ)⁶¹ synim kryesor kishte që ta pengonin në ngritjen e mëtejshme profesionale. Përkundër të gjitha vështirësive, ai i vazhdoi dhe i përfundoi studimet me sukses. Pasi kishte fituar njohuri të shkëlqyeshme në fushën e artilerisë, u emërua komandant i kompanisë artilerike në Vërshac.

⁵⁹ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës*, 8, Prishtinë, 2004, f. 79-80.

⁶⁰ Miftar Kurti, Bisedë me komandantin Shemi Ahmeti, Bare, shkurt 1999.

⁶¹ Deri në vitin 1992 quhej APJ, kurse pas zhbërjes së Jugosllavisë së Titos, me krijimin e Jugosllavisë Serbi-Mali i Zi, në vitin 1992, në Kushtetutë emërtohet Ushtria Jugosllave (UJ) („Службени лист Савезне Републике Југославије“, година I, број 1/92, Београд, петак, 3. јануар 1992 (<https://sr.wikisource.org/sr-ec> qasja 26.09.2025)).

Me fillimin e zhbërjes së Jugosllavisë në fillim të viteve '90 të shekullit XX, mori pjesë në shumë beteja, që nga Knini e deri në Vukovar në luftën serbo-kroate. Edhe pse kaloi nëpër sfida dhe rreziqe që sjell çdo luftë për ushtarët dhe eprorët, fatmirësisht shpëtoi i gjallë nga lufta serbo-kroate. Në atë luftë kishte parë dhe përjetuar tmerrin. E vetmja e mirë që fitoi në luftë ishte përvoja luftarake, por mësoi edhe për qëllimet pushtuese të Serbisë. Uniforma që e bartte dita-ditës i bëhej e huaj dhe e neveritshme. Ishte i vetëdijshëm se ndodhej në një ushtri, e cila popullit të tij i kishte shkaktuar shumë dhimbje e tragjedi. Me shpërbërjen e Jugosllavisë së Titos dhe me krijimin e Jugosllavisë së Millosheviçit (Serbi-Mali i Zi) në vitin 1992, ai e braktisi Ushtrinë Jugosllave dhe u kthye në Kosovë. Kosovën e gjeti krejt tjetër nga ajo çfarë e kishte lënë kur kishte filluar studimet në akademinë ushtarake në APJ. E gjeti në pushtim klasik. Në rrethanat që ndodhej Kosova, ai nuk mund të lëvizte i lirë. Ishte i vetëdijshëm se do ta kërkonte pushteti serb, jo për ta kthyer atje ku ishte, por për ta burgosur, ndoshta diçka edhe më keq. Jetën e vazhdoi me shumë sfida në Kosovën e robëruar, pa qenë asnjëherë i sigurt për jetën e tij. Përkundër të gjitha këtyre, gjatë asaj kohe, ai nuk e kaloi kohën kot. Lexoi me pasion dhe mësoi historinë e popullit shqiptar për të cilën nuk kishte pasur mundësi sa ishte në shkollimin ushtarak. Mësoi për ngjarjet kryesore historike shqiptare, për të bëmat e personaliteteve të mëdha kombëtare, si për: Skënderbeun, Isa Boletinin, Hasan Prishtinën, pastaj për heroizmat e Ahmet Selacit e Ymer Selacit, Ukshin Kovaçicës, Bislim Bajgorës, Shaban Polluzhës, Azem Bejtës e personaliteteve të tjera. Për luftën dhe qëndresën e atdhetarëve të Shalës së Bajgorës kishte dëgjuar dhe mësuar nga babai i tij, Arifi.

Inkuadrimi në radhët e UÇK-së dhe emërimi i tij komandant i Kompanisë

Sipas fqinjtit të tij, komandantit të Njësisë për Intervenime të Shpejta të UÇK-së, Rexhep Suma, gjatë një takimi që kishte pasur me Shemsi Ahmetin në shtator 1997, ai kishte deklaruar: *“Tani edhe ne shqiptarët e kemi radhën të futemi në luftë”*. Që nga ajo kohë ai ishte deklaruar i gatshëm që të futej në luftë me të gjitha kapacitetet.⁶² Mesi i vitit 1998, pas sulmeve të forcave serbe në Likoshan, Qirez e Prekaz të Drenicës (shkurt-mars 1998), Shemsi Ahmetin

⁶² Agjencia e Arkivave Shtetërore të Kosovës (AASHK), Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandanti i lirisë (Dëshmorit të Kombit Shemsi Ahmeti”, Rexhep Suma për Shemsi Ahmetin, 14. 10. 2010.

do ta gjejë nën emblemën e UÇK-së në rajonin e Shalës së Bajgorës. Bazuar në njohuritë që kishte nga lëmi i artit ushtarak, inkuadrimin e tij në radhët e UÇK-së, shokët e pritën me admirim. UÇK-së iu shtua edhe një ushtarak profesionist, një komandant, një ekspert i artilerisë, mungesa e të cilëve, në fillimet e veprimtarisë së UÇK-së në Shalë, ishte tepër madhe. Më 22 qershor 1998, tetë ditë para se të formohej Brigada 141 “Mehë Uka”, Shemsi Ahmeti (me nofkën Shemi) inkuadrohet në radhët e UÇK-së dhe emërohet komandant i Kompanisë në Trepçali.⁶³

Pas vendosjes së “rampës” (laurës) pranë Xhamisë së Mazhiqit, në magjistralen Mitrovicë-Podujevë, më 18 qershor 1998, ditën kur ishte marrë nën kontroll nga ushtarët e UÇK-së Fabrika e Galënterisë në Bare, dhe me vendosjen e komandant Shemsi Ahmetit në Trepçali, më 22 qershor 1998, UÇK-ja e mori nën kontroll rajonin e Shalës, duke filluar nga Trepçalitë⁶⁴ e Mazhiqi⁶⁵ (në perëndim), Selaci (në veri) e deri në fshatin Kaçanoll⁶⁶ (në lindje). Në Trepçali ishte mirëpritur dhe çmohej shumë nga bashkëluftëtarët dhe nga banorët. Fillimisht njoftohet me pozicionet ku ushtarët e UÇK-së ishin vendosur para se ai të shkonte atje, me rojën, vend-vrojtimin, rrugët e mundshme nga mund të sulmonin forcat armike. Më 23 qershor, komandant Shemi shkon në Mazhiq, ku takohet me komandantin Ajet Bajrami, me të cilin i koordinojnë punët për rregullimin e pozicioneve aty ku nuk kishte dhe, me përforcimin e pozicioneve luftarake, aty ku kishte në zonën e tyre të përgjegjësisë. Në ditët në vijim, Shemsi Ahmeti, siç rrëfen bashkëluftëtari e tij në Trepçali, Haki Istrefi, i emëroi skuadërkomandantët e togëkomandantët dhe e strukturoi kompaninë, filloi aktivitetin e ngjeshur sipas orarit dhe planit që ai e kishte bërë. Zgjimi i ushtarëve bëhej në ora 06:00 të mëngjesit, ku pas zgjimit ata fillonin gjimnastikën, bënin ndërrimin e rojës, hanin mëngjesin, pastaj kalonin në ushtrime taktike deri në ora 13:00. Pasdreke vazhdonin me stërvitje. Komandanti, jo larg pozicioneve, rregulloi dhe një poligon stërvitjesh me pengesa. Qysh në fillim e dëshmoi se ishte i disiplinuar, por edhe shumë rigoroz në detyrat dhe përgjegjësitë e tij.⁶⁷

⁶³ Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Zona Operative e Shalës, Lista e Dëshmorëve të ZOSH, Arkivi i Zonës IV Mbrojtëse të TMK-së, Sektori Ushtarako-Civil, 2001.

⁶⁴ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës (Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku)*, Vëllimi 8, Prishtinë, 2003, f. 129-131.

⁶⁵ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës...*, f. 90-91.

⁶⁶ Po aty, f. 74-75.

⁶⁷ Haki Istrefi, *Fletore kujtimesh 1998-1999*, Mitrovicë, 31. 08. 2012; AASHK, Fondi Emin Kabash, Dosja “Komandanti i lirisë” (Dëshmorit të Kombit Shemsi Ahmeti).

Siç rrëfejnë bashkëluftëtarët tjerë në Trepçali dhe Mazhiq (Emin Musa, Rexhep Suma, Kadri Istrefi, Kadri Hajdari, Ali Berisha, A. Ferati etj)⁶⁸, që nga fillimi ai kishte treguar afërsi me bashkëluftëtarët e tij, ishte korrekt, i disiplinuar dhe shumë i përkushtuar në kryerjen e detyrave. Me shumë përkushtim e profesionalizëm bënte përgatitjen morale, psiko-fizike e taktike të ushtarëve. Ngase një pjesë e konsideruar e ushtarëve ishin pa shërbim të kryer ushtarak, ata i mësonte si t'i përdornin llojet e armëve në dispozicion, si t'i kryenin detyrat e tyre në luftë, duke filluar nga detyrat e korrierit, furnizuesit me municion dhe vrojtuesit e shoferit të automjetit, si ta njihnin armatimin që posedonin dhe si ta mbanin atë në gatishmëri, si të luftonin në mënyrë të qetë dhe të saktë, si ta përdornin municionin me kujdes, si të ishin të kujdesshëm në rregullimin eistikameve dhe si të maskoheshin, si t'i ruanin dhe mbronin shokët (bashkëluftëtarët), si t'i përcillnin sinjalet dhe si të vepronin sipas tyre, pse nuk duhej të ndaheshin pa leje nga shokët dhe nga njësitë (grupi, skuadra, toga e kompania), pse nuk guxonin të lejonin të bien në duart e armikut dhe pse nuk guxonin ta zbulonin sekretin ushtarak. Po ashtu, gjatë stërvitjeve, komandanti Shemsi Ahmeti i mësonte dhe i stërviste ushtarët si të jenë vrojtues të mirë të skuadrës, togës e kompanisë, vendin që duhet ta zënë gjatë vrojtimit, distancën që duhet ta mbajnë, mënyrën se si të orientohen, çfarë të dhënash duhet të mbledhin mbi armikun, zonën e vrojtimit, detyrat (zbulimi i caqeve të armikut), specifikat e vrojtimit ditën dhe natën. Gjithashtu, gjatë fazës së përgatitjes së Kompanisë, ai udhëzonte ushtarët se si dhe kur duhet të lëvizin në sulm me hapa, kur me hapa vrap dhe kur me vrap, kur këmbadoras, kur barkas dhe kur në ije, kur mund të lëvizin pa komandë dhe kur me komandë, veprimet që duhet t'i bëjnë për të lëvizur drejt pozicionit të zjarrit, në sulm kundër armikut, kalimi nga një pozicion në tjetrin, kur dhe si duhet të hapin zjarr kundër armikut, si duhet ta zgjedhin cakun, si të shënjestrojnë pikën e marrjes së shënjestrës dhe sasinë e municionit. Përveç këtyre, ai u fliste ushtarëve edhe për skuadrat e këmbësorisë, skuadrat vëzhguese, të mitralozave, të mortajave, të minahedhësve e topave pa dridhje, togjet e kompanitë, llojet dhe detyrat e tyre. Ushtarët i stërviste edhe për mënyrën e marrjes së objektit dhe spastrimin e terrenit, lëshimin dhe ngjitjen me litar, ndalimin dhe bllokimin e kolonave të forcave policore dhe ushtarake të armikut. Me ushtarët kryente edhe stërvitje të tjera taktike.⁶⁹

⁶⁸ AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja "Komandanti i lirisë (Dëshmorit të Kombit Shemsi Ahmeti).

⁶⁹ AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja "Komandanti i lirisë (Dëshmorit të Kombit Shemsi Ahmeti).

Pozicionet kryesore të kompanisë që komandonte Shemsi Ahmeti në Batalionin e Dytë, edhe gjatë stërvitjeve, edhe gjatë luftimeve, ishin në fshatin Trepçali, buzë magjistrales Mitrovicë-Podujevë, të cilat, në anën e majtë, lidheshin me Mazhiqin, Rashanin dhe shkonin deri te pozicionet e Kompanisë tjetër në Pasomë, kurse në të djathtën lidheshin me pozicionet e Batalionit të Tretë në Melenicë, Lagja Cenaj dhe Rahovë. Njëra nga detyrat kryesore të përcaktuar nga komandant Shemi, për ushtarët e kompanisë së tij, pas përfundimit të stërvitjeve dhe fillimit të luftimeve, ishte bllokimi i rrugës kryesore të Xhamia e Mazhiqit (magjistranja Mitrovicë-Podujevë) në një pozitë strategjike dhe mbajtja nën vëzhgim të vazhdueshëm të rrugës kryesore të Minierës “Trepça” në Stantërg. Kompania në Trepçali mbante në kontroll çdo lëvizje të forcave serbe në Magjistralen në fjalë.⁷⁰ Një pjesë të kompanisë e kishte vendosur në shtëpinë e Bislim Maliq Trepçës. Me stërvitje intensive, me rregullim dhe fortifikim të pozicioneve luftarake, kishte kaluar ditë, javë e muaj në zonën e përgjegjësisë. Nga 10 korriku e deri më 15 shtator 1998 u zhvilluan luftime të ashpra në të cilat mori pjesë, për të cilat do të flasim pak më vonë. Periudha nga fundi i shtatorit e deri në dhjetor 1998 shënon përpjekjet maksimale për riorganizim dhe ristrukturim të njësiteve të brigadës dhe ZOSH. Në këtë kohë, komandanti Shemsi Ahmeti martohet.⁷¹

Emërimi komandant i Njësisë Speciale, i Njësisë së Artilerisë dhe i Kazermës në Bare

Edhe pse, që nga korriku i vitit 1998, për komandantin Shemsi Ahmeti dhe veprimtarinë e tij kam dëgjuar nga disa bashkëluftëtarë, derisa ai ishte Komandant Kompanie në Trepçali, atë e kam takuar për herë të parë më 23 janar 1999 në fshatin Bare. Ishte stinë dimri. Ishte mesi i ditës. Kishte kohë që mjegulla dhe bora kishin mbuluar shtigjet në rajonin e Shalës së Bajgorës. Atë ditë koha ishte e vranët, binin riga shiu me flluska bore. Balta e bora qenë përzier atë ditë në oborrin e shkollës-kazermë në fshatin Bare, siç përziheshin e bardha me të zezën, e bukura me të shëmtuarën, dhimbja me urrejtje. Për një moment, derisa ishim duke pushuar me disa bashkëluftëtarë në oborrin e kazermës, para nesh ndalet një xhip që e ngiste ndihmës komandanti për Logjistikë në Brigadën 141, Behxhet Bala. Me atë xhip Behxhet Bala e solli

⁷⁰ Haki Istrefi, Fletore kujtimesh 1998-1999, Mitrovicë, 31. 08. 2012.

⁷¹ AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandanti i lirisë”, Kadri Istrefi për Shemsi Ahmetin, tetor 2010.

komandantin Shemsi Ahmeti, të cilin Komanda e Brigadës e kishte emëruar komandant të Njësisë Speciale. Ishte i veshur me pedanteri me uniformë ushtarak, tamam si i ka hije një ushtaraku. Kishte trup mesatar, ishte shpatullgjerë, tip sportiv, i rruar mirë në fytyrë, kishte flokë gështenje, të shkurta. Dukej i qetë dhe mbante qëndrim serioz. Aty, në oborrin e kazermës, për herë të parë u përshëndetëm me të, i shtrënguam duart njëri-tjetrit. Rënia e komandantit Xhevat Jusufi dhe plagosja rëndë e komandantit tjetër, Zymer Halimi (3 janar 1999), kishte lënë një boshllëk të madh, kishte ndikuar në rënien e moralit tek ushtarët, por hetohej shumë edhe mungesa e kuadrit profesional komandues. Kjo kishte ndikuar te të gjithë ata që ishin të vendosur në kazermën e Bares dhe tek ata që ishin vendosur në vijën e parë të frontit, të cilën duhej ta mbanin nën kontroll çdo metër të magjistrales nga krahina e Shalës e deri në krahinën e Llapit, sepse kjo ishte një pengesë e madhe për armikun. Emërimi i Shemsi Ahmetit komandant i Njësisë Speciale ishte një sihariq, ishte një risi, ushtarëve u dha zemër e u dha krahë. Pas dhimbjes së madhe që kishte shkaktuar rënia e Xhevat Jusufit dhe plagosja e Zymer Halimit, 23 janari 1999 solli dy gëzime përnjëherësh. Gëzimi i parë ishte lajmi për lirimin e nëntë ushtarëve të UÇK-së, të zënë rob nga Ushtria Jugosllave, më 14-15 dhjetor 1998, në zonën kufitare Kosovë-Shqipëri, si rezultat i marrëveshjes së ndërmjetësuar nga SHBA, BE dhe OSBE.⁷² Gëzimi i dytë i asaj dite për ushtarët e Njësisë Speciale dhe të gjithë ushtarët në kazermën e Bares, por jo vetëm, ishte emërimi i Shemsi Ahmetit komandant i Njësisë Speciale.

Punën me Njësinë Speciale e filloi pa vonesë, që ditën e parë, pra më 23 janar 1999, në Bare. Fillimisht u njoh me ata të cilëve do t'u printe, u njoh me gjendjen dhe kushtet në të cilat vepronte Njësia Speciale, të cilën brenda një kohe e riorganizoi dhe ristrukturoi. Zëvendëskomandant të Njësisë Speciale emëroi Sabri Hazirin, ndihmëskomandant për Çështje Personale emëroi Miftar Kurtin, ndihmëskomandant për Logjistikë Hajzer Kurtin, kurse vozitës Rrustem Rrustemin. Në kohën kur komandën e mori Shemsi Ahmeti, kjo njësi kishte tri togje. Komandant i Togës I ishte Sabri Haziri, i Togës II – Nuhi Sejdiu, i Togës III – Ali Berisha. Shefqet Begu, që nga fillimi i formimit të Njësisë Speciale, i ka udhëhequr stërvitjet fizike-kondicionale, ndërsa në periudhën nga 3 deri më 22 janar 1999 ishte caktuar përgjegjës. Çdo togë kishte nga tri skuadra. Komandantët e skuadrave dhe grupeve ndërroheshin shpesh,

⁷² Miftar Kurti, “Këmbimi i robërve të luftës mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Ushtrisë Jugosllave:”, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës vlerë kombëtare*, Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, Prishtinë, 2022, f. 233-248; Koha ditore, 23 janar 1999.

sepse çdo ushtar i kësaj njësie, në një mënyrë a një tjetër, e kishte ushtruar dhe detyrën e skuadërkomandantit ose të komandantit të grupit.

Në kuadër të organizimit dhe riorganizimit, komandant Shemi caktoi orarin e rojës në objekt, të zgjimit nga gjumi, kohën për ushqim, për stërvitje, por edhe për përgatitjen e istikameve. Nisi inspektimet për të parë gjendjen e armatimit në dispozicion, sasinë e tij, gjendjen e depove të logjistikës (armatimit, municionit dhe artikujve ushqimorë). Vazhdoi inspektimet në pozicione ku duhej të ndërtoheshin bunkerë, kanale pozicione dhe fortifikime tjera sipas nevojave dhe situatës. Kontaktin me komandën e Brigadës e kishte të përditshëm. Kuzhinën e transferoi nga kazerma në Fabrikën e Galanterisë, ku kushtet higjienike ishin dukshëm më të mira. Meqë kushtet e fjetjes nuk ishin siç duhej, sepse ushtarët flinin në sfungjerë të shtruar në dysheme nëpër klasë, mori masa që të rregullohen shtretër dy-tre katesh, tamam si në kazerma ushtarake. Pranë shtretërve të ushtarëve u vendosën rafta për rroba, për armatim dhe për gjëra të tjera. Pastërtia arriti në nivel të lartë, u krijuan kushte komode për fjetje, aq sa lejojnë rrethanat e luftës, por edhe për ushqim. Për ata që ishin të interesuar të lexonin libra në kohën e lirë, e aktivizoi bibliotekën e shkollës, e cila ishte mjaft e pasur, sidomos me libra të fushës së letërsisë, historisë dhe publicistikës. Krejt kjo që bërë brenda pak ditësh. Shumë shpejt çdo gjë e vuri në kontroll, e vuri në vijë. Krijoi rregull, disiplinë, që, për hir të vërtetës, Njësisë Speciale nga formimi nuk i kanë munguar. Komandanti u angazhua edhe për pajisjen dhe kompletimin e ushtarëve me uniforma, me armatim të domosdoshëm dhe të mjaftueshëm, me fishekë dhe me gjoksore, për të cilat ishte angazhuar maksimalisht edhe më herët komandant Besi. Puna më e madhe po bëhej në vazhdimin e përgatitjeve fizike e taktike të ushtarëve dhe në sprovimin e tyre në aksione kundër forcave serbe. Edhe pse kishte të bënte me një njësi të stërvitur dhe të konsoliduar mirë nga komandant Besi, puna me Njësinë Speciale në fillim i solli disa vështirësi, e ballafaqoi me disa pengesa e sfida. Mirëpo, me urtësi, me profesionalizëm, përkushtim e angazhim maksimal i kaloi me sukses të gjitha sfidat, sepse natë e ditë punonte, stërvitej vet dhe stërviste vartësit e tij.

Sfidat dhe dinamika e punës u shtuan shumë pasi komandanti Shemi Ahmeti, në muajin shkurt 1999, e formoi Njësitin e Artilerisë. Formimi i këtij njësi u bë i mundur ngase Komanda e Brigadës kishte siguruar minahedhës 120mm, 82mm dhe 60mm, topa pa dridhje, mortaja e gulinova 12.7 (kundërajror). Përgatitja e këtij njësi i mori kohë dhe energji shtesë. Kësisoj, Komandant Shemi, brenda një kohe të shkurtër u ngarkua dhe i kreu tri

detyra dhe përgjegjësi komanduese: komandant i Njesisë Speciale, komandant i Njësitit të Artilerisë dhe komandant i Kazermës në fshatin Bare, më të madhen e asaj kohe në rajonin e Shalës. Meqë në kazermën e fshatit Bare ishin vendosur Njësia Speciale, Njësi i Artilerisë, logjistika, shërbimi për mirëmbajtjen e armëve, por edhe një pjesë e logjistikës së Brigadës 141, ai bëri një riorganizim dhe ristrukturim në nivel të kazermës në Bare. Ai emëroi dy zëvendëskomandantë: zëvendëskomandant për Njësinë Speciale - Sabri Haziri, zëvendëskomandant për Njësitin e Artilerisë në kuadër të kazermës u emërua Sherif Dibrani, kurse vartës të Dibranit në Njësinë e Artilerisë u emëruan Nexhmedin Mustafa dhe Bajram Ahmeti. Dy ndihmëskomandantët e Njesisë Speciale (M. Kurti dhe H. Kurti) vazhduan ta kryejnë të njëjtën detyrë edhe në nivel të kazermës.




Figura 1. *Struktura e Njesisë Speciale dhe kazermës në Bare*

Në nivel të Zonës Operative të Shalës janë të regjistruara në kujtesën e popullit dhe atyre që morën pjesë drejtpërdrejt në luftime një varg aksionesh, sulmesh, betejash dhe veprimesh tjera luftarake. Si beteja kryesore në zonën e përgjegjësisë së Zonës Operative të Shalës, sipas komandantit të kësaj zone, Rrahman Rama, veçohen Betejat e Majdanit, Pretenit, Melenicës, Mazhiqit dhe Pasomës (në zonën e përgjegjësisë së Brigadës 141 “Mehë Uka”) si dhe betejat e Ashlanit, Vaganicës dhe fshatrave rrëzë Qyqavicës (në Brigadën 142).⁷³ Shemsi Ahmeti shkëlqeu si komandant në betejat e Trepçalive dhe

⁷³ *Kosova sot*, 25 mars 2000, f. 10.

Mazhiqit (korrik-shtator 1998), në Betejën e Trepçalive (13 mars-26 prill 1999), në Betejën e Rahovës (5-6 prill 1999) dhe në Betejën e Majdanit (15-26 prill 1999).

Beteja e Trepçalive dhe Mazhiqit (korrik-shtator 1998) dhe roli i komandantit

Komandanti Shemsi Ahmeti kishte përvojë luftarake si komandant, edhe para se të inkuadrohej në radhët e UÇK-së. Dijen e tij prej ushtaraku dhe përvojën e tij luftarake i vuri në veprim maksimalisht në luftën çlirimtare në Kosovë. Nga 23 qershori e deri në dhjetëditëshin e parë të muajit korrik 1998, u angazhua jo vetëm në përgatitjen psiko-fizike dhe taktike të ushtarëve, por edhe për rregullimin e istikameve në Trepçali⁷⁴, ku vëmendje të veçantë i kushtoi rregullimit të pozicioneve që e mbanin nën kontroll magjistralen Mitrovicë-Podujevë, e cila ishte rruga kryesore nga mund të sulmonin dhe depërtonin forcat serbe dhe jugosllave në rajonin e Shalës së Bajgorës. Shemsi Ahmeti ndihmoi dhe kontribuoi edhe për përgatitjen e istikameve të Shkoza e Mazhiqit, përballë bazës ushtarake të Ushtrisë Jugosllave në Kutllovc.

Në fshatin Mazhiq⁷⁵, më 10 korrik 1998, filluan sulmet e pjesëtarëve të UÇK-së kundër pjesëtarëve të forcave serbe në bazën ushtarake serbe në Kodrën e fshatit Kutllovc⁷⁶, të cilët kishin hipur në Antenë dhe vëzhgonin pozicionet e UÇK-së. Të nesërmen, më 11 korrik, forcat serbe nga baza ushtarake e UJ-së në Kutllovc nisën sulmin në pozicionet e UÇK-së në Mazhiq. Gjatë luftimeve të saj dite u plagosën Lulzim Musa, Naser Islami, Ali Zeneli (Brigada 141) dhe Gyrner Murati nga Nënzona Operative e Llapit.⁷⁷ Në ato luftime, komandant Shemi tregoi guxim, gatishmëri për sakrificë dhe shkathtësi vepërimi. Pas disa ditësh, ai mori një njoftim nga banorët e Trepçës⁷⁸ se grupe dhe njësite ushtarake paramilitare e speciale, ishin vendosur në Trepçë, të cilët po i largonin dhunshëm banorët e katër lagjeve rreth Minierës “Trepça” në Stantërg. Për tri javë rresht, sipas Haki Istrefit, ushtarët në krye me komandantin Shemsi Ahmeti, qëndruan në shkallën më të lartë të gatishmërisë. Meqë pozicionet luftarake në Mazhiq nuk po thyheshin dot, për shkak të qëndresës

⁷⁴ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Vëllimi 8...*, f. 129

⁷⁵ Po aty, f. 90-91.

⁷⁶ Po aty, f. 82.

⁷⁷ Ajet Bajrami, *Ditar lufte*, dorëshkrim, korrik 1998.

⁷⁸ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Vëllimi 8...*, f. 110-114

së madhe që bënin ushtarët e Batalionit II në krye me komandantin Ajet Bajrami, të ushtarëve të Njësisë për Intervenime të Shpejta në krye me Rexhep Sumën, më 19 gusht 1998 nisin lëvizjet e forcave serbe nga Lagja “Angleze” në Trepçë në drejtim të pozicioneve të kompanisë në Trepçali, prej nga mund të rrezikoheshin pozicionet luftarake të “Kërshi i Love”, por jo vetëm. Në atë pozicion luftarak, atë ditë, ishte Eset Ibishi me bashkëluftëtarë. Duke i parë lëvizjet e disa oficerëve të policisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MPB) në atë pjesë, Eset Ibishi, me pushkën e tij M48, godet për vdekje një oficer policie.⁷⁹ Pas këtij momenti, komandant Shemi urdhëron ndërrimin e pozicioneve luftarake prej nga ishte qëlluar oficeri serb i policisë dhe, pa u hetuar, ofrohet më afër forcave armike. Një lëvizje e tillë taktike e komandantit Shemi Ahmeti i shpëtoi pa pasoja ushtarët e tij nga kundërsulmet e armikut. Atë ditë pozicionet e UÇK-së në lagjet e Trepçalive sulmohen me artileri nga baza ushtarake serbe në Kutllovc, por edhe nga Lagja “Angleze”, ku ishte qëlluar për vdekje oficeri i tyre. Komandant Shemi mori masat e duhura që banorët e Trepçalive të futeshin në bodrume të shtëpive të tyre për të shpëtuar nga sulmi i artilerisë së Ushtrisë Jugosllave. Ky veprim i komandantit shpëtoi nga më e keqja shumë banorë. Mirëpo, pas tri orë të sulmeve me artileri, armiku qëlloi edhe shtëpinë e Hajredin Trepçës, në oborrin e shtëpisë të të cilit bien disa predha të artilerisë dhe plagosin dy vajzat e tij, Lumnijen dhe Melihatën. Qarkullimi në magjistralen Mitrovicë-Podujevë u rrallua shuma. Duke e parë se situata po përkeqësohej gjithnjë e më shumë, me urdhër të komandant Shemit, jo larg Xhamisë së Mazhiqit, mbyllet magjistralja të “Kërshi i thyem”. Në një hapësirë prej 100 metrash vendosen gurë dhe dru. Tani qarkullimi bëhej vetëm nga ana e Vushtrrisë (Smerkonicë-Pasomë). Luftimet intensifikohen më 21 gusht në Mazhiq e Trepçali, kurse intensiteti i tyre arriti kulmin më 15 shtator 1998.⁸⁰

Më 15 shtator 1998, sulmi në Shalë nisi nga tri drejtime: nga Mitrovica, Vushtrria dhe Podujeva. U sulmuan përnjëherësh Mazhiqi, Trepçalitë, Melenica, Lagja Cenaj e Stantërgut, Pasoma dhe Kaçanolli⁸¹. Sipas rrëfimeve të Osman Musës, babai i dëshmorit Nysret Musa, i cili në atë kohë ishte me banim në Tunelin e Parë, më 15 shtator 1998, vetëm nga Mitrovica në drejtim të

⁷⁹ Haki Istrefi, *Fletore kujtimesh 1998-1999*, Mitrovicë, 31. 08. 2012; Miftar Kurti, “Veprimtaria luftarake e Zonës Operative të Shalës sipas shtypit serb dhe malazias (1998-1999)”, Radio Kosova e Lirë.

⁸⁰ Po aty.

⁸¹ Po aty.

Shalës, nëpër magjistrale, ishin nisur mbi 270 automjete ushtarake e policore: tanke, transportues, autoblanda, kamionë me ushtarë, praga, pizgauerë, autoambulanca dhe automjete bartëse të topave të artillerisë (haubica, minahedhës 120mm, 82 mm e 60 mm).⁸² Sipas eprorëve të UÇK-së (Zymer Halimi e Mensur Kosumi), Ushtria Jugosllave kishte sulmuar Shalën e Bajgorës me një korpus.⁸³ Atë ditë, që në mëngjes, pozicionet e UÇK-së në Mazhiq u sulmuan me shumë ashpërsi. Rreth orës 10, komandant Shemi urdhëron katër ushtarë të shkojnë në Mazhiq për të parë si ishte gjendja në pozicionet atje, sepse pozicionet luftarake në Mazhiq ishin në një vijë me pozicionet në Trepçali. Atje armiku sulmonte me tanke, këmbësori e artileri të rëndë nga baza ushtarake e UJ-së në Kutllovc.⁸⁴ Këtë e dëshmojnë ushtarët që i raportuan Shemi Ahmetit për shumë të plagosur dhe një pjesëtar të UÇK-së të vrarë (Avni Shabanin). Sapo merr këtë informacion, komandant Shemi, bashkë me ushtarët nga të cilët kishte marrë lajmin për gjendjen në Mazhiq, nisët për të marrë pjesë në luftime atje, kurse në Trepçali cakton një përgjegjës për ta menaxhuar situatën.⁸⁵

Sulmi i befashëm i forcave serbe në anën perëndimore të Melenicës, më saktë në Lagjen Cenaj të Stantërgut⁸⁶, ku ra dëshmor Enver Ferizi dhe u martirizuan babai i tij, Halim Ferizi, bashkë me mikun e shtëpisë, Rizah Tahiri (Selaci), si dhe plagosja shumë rëndë e pjesëtarit të UÇK-së, Besim Ismajli⁸⁷, bëri që forcat serbe të krijonin epërsi, duke e bërë të pamundur mbajtjen e pozicioneve luftarake në Melenicë, me gjithë rezistencën dhe humbjet që ua kishin shkaktuar forcave armike pjesëtarët e Batalionit të Tretë. Komandant Shemi, duke e parë se forcat serbe po tentonin të futeshin në pozicionet në Mazhiq dhe Trepçali, me snajperin e tij qëllon dhe vret disa prej tyre. Mungesa e armëve dhe municionit, numri i vogël i ushtarëve, mungesa e përvojës luftarake dhe humbjet e pësuar në Betejën e Mazhiqit, por edhe në Betejën e

⁸² AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandant i lirisë”, Rafet Ibishi për Shemi Ahmetin, tetor 2010.

⁸³ Izedin Krasniqi, “Është thirrja e atdheut që duhet të jetë mbi të gjitha”, Kombi, 21 dhjetor 1998; Izedin Krasniqi, *Lugina e lotëve*, Lena Graphis Desing, Prishtinë, 2021, f. 165-169.

⁸⁴ Miftar Kurti, Intervistë me Emin Musa, Trepçë, 5 janar 2013; Miftar Kurti, Intervistë me Rexhep Sumen, 22 dhjetor 2012; RTK, Dokumentari për Rrustem Hysenin (Historinin) të autores Blerta Dalloshi.

⁸⁵ Haki Istrefi, *Fletore kujtimesh 1998-1999*, Mitrovicë, 31. 08. 2012.

⁸⁶ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës*, Vëllimi 8, Prishtinë, 2003, f. 110-114

⁸⁷ Miftar Kurti, Bisedë me Besim Ismajlin, Mitrovicë, 6. 09. 2018. Miftar Kurti, Bisedë me bashkëshorten e dëshmorit, Enver Ferizi, Mitrovicë, 01. 03. 2018.

Melenicës, e detyrojnë komandën e Brigadës të urdhërojë tërheqjen në pozicione rezervë të njësisve nga Mazhiqi, Trepçalitë e Melenica.⁸⁸ Përgatitja e duhur psiko-fizike dhe taktike e ushtarëve, manovrimi i suksesshëm në terren gjatë ofensivës së armikut, bëri që ushtarët e Kompanisë së tij të shpëtojnë dhe të tërhiqen me sukses dhe sipas urdhrat.

Në luftimet e 15-17 shtatorit 1998, në Betejën e Mazhiqit bien dëshmorë: Avni Shabani dhe Rifat Zeneli (kurse motra e Rifatit digjet në shtëpi nga forcat serbe); në Lagjen Cenaj: Enver Ferizi; në Betejën e Kaçanollit: Ramadan Behrami, Fetah Behrami, Jashar Behrami, Musë Begu, Ilaz Hyseni dhe Elez Begu (nga Brigada 141 “Mehë Uka”); si dhe 7 dëshmorë nga Zona Operative e Llapit (ZOLL): Fadil Sejdiu-Noli, Beki Lushtaku, Nazmi Zhegrova, Bekim Maliqi, Habib Zeka, Islam Rekalio dhe Selim Rekalio. Ndërkaq, në Pasomë bie dëshmor Abedin Ferizi.⁸⁹

Nga 10 korriku deri më 15 shtator 1998, komandanti Shemsi Ahmeti ishte njëri nga protagonistët kryesorë në luftë kundër policisë, ushtrisë dhe paramilitarëve serbë. Dëshmi për këtë janë rrëfimet e disa bashkëluftëtarëve të tij.⁹⁰

Beteja e Trepçalive, sulmi në bazën ushtarake serbe në Kutllovc, në stacionin e policisë serbe në Trepçë dhe në kazermën e UJ-së në Bajër të Mitrovicës (13 mars-29 prill 1999)

Rimarrja nën kontroll e pozicioneve në Trepçali, në Magjistralen Mitrovicë-Podujevë dhe pozicione tjera nga Njësia Speciale dhe njësitet tjera të Brigadës 141, ndodhi përgjatë periudhës kohore tetor-dhjetor 1998. Me formimin e Njësitit të Artilerisë (shkurt 1999) vendosen mbi kodrën e Trepçalive minahedhësit 120mm, 82mm dhe 60mm, topat pa dridhje, gulinovët 12.7 dhe mitralozat tjerë të rëndë. Meritën kryesore për fortifikim në Kodrën e Trepçalive e kanë komandantët Shemsi Ahmeti dhe Zymer Halimi. Duhet thënë se që nga muaji tetor '98 deri në fillim të marsit '99, përlëshjet në këto pozicione ishin sporadike. Tentimet e forcave armike në ditët e fundit të dhjetorit 1998 dhe në ditët e para të muajit janar 1999, për të depërtuar në Shalë nga ky korridor, dështuan që në fillim. Kjo u pa me rastin e zënies rob

⁸⁸ Ditari Operativ i Brigadës 141 “Mehë Uka”; Haki Istrefi, Fletore shënimesh, 1998.

⁸⁹ TMK-ZIVM, Sektori G5, Lista e dëshmorëve të Brigadës 141 “Mehë Uka”, Mitrovicë, 2007; Skender Zhitia, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës...*, f. 157.

⁹⁰ AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandanti i lirisë”; Haki Istrefi, Fletore kujtimesh 1998-1999, Mitrovicë, 31. 08. 2012.

të 8 ushtarëve të Ushtrisë Jugosllave nga Njësia Speciale dhe Policia Ushtarake e UÇK-së në Shalë, më 8 janar 1999, në hyrje të fshatit Bare.⁹¹ Pas këtij dështimi, forcat serbe e kuptuan se përpjekjet e tyre për të depërtuar në pozicionet e UÇK-së në Shalë nëpër Mazhiq, Trepçali dhe nëpër magjistralen Mitrovicë-Podujevë ishin të dënuara të dështonin. Gjatë muajve janar dhe shkurt 1999, sulmet e forcave serbe u përqendruan në pozicionet e UÇK-së në zonën e përgjegjësive të Brigadës 142, përkatësisht në Vaganicë e Shipol të Mitrovicës dhe në fshatrat rrëzë Qyqavicës.⁹²

Derisa po mbahej Konferenca e Rambujesë (6-23 shkurt 1999)⁹³, në Kosovë kishte filluar Operacioni “Patkoi” i Ushtrisë Jugosllave.⁹⁴ Operacioni po shtrihej në zonën e përgjegjësive të ZOSH, përkatësisht në pjesën veriore të Kosovës (Vushtri e Mitrovicë). Në muajin shkurt, rrëzë fshatrave të Qyqavicës, që ishin në zonën e përgjegjësive të Brigadës 142 të ZOSH, zhvillohen luftime të ashpra si rezultat i Operacionit në fjalë. Luftimet atje do të zgjasin nga 22 shkurti deri më 17 mars 1999. Në ato luftim e morën pjesë intensivisht edhe pjesëtarë të Njësive Speciale të Brigadës 141 “Mehë Uka”. Për shkak të detyrave dhe përgjegjësive komanduese, për shkak se ishte i ngarkuar ta mbante në kontroll arterien kryesore në Shalë (Magjistralen Mitrovicë-Podujevë) dhe për shkak se komandonte Njësitin e Artilerisë nga Barja e Kodra e Trepçalive, komandant Shemi qëndroi në Shalë prej nga veproi me shumë sukses. Derisa pozicionet e UÇK-së në fshatrat rrëzë Qyqavicës rrezikonin të pushtoheshin nga forcat armike, me urdhër të komandantit të Zonës (Rahman Rama), të Brigadës 141 (Hysni Ahmeti), komandanti Shemi Ahmeti, më 13 mars 1999, me Njësitin e Artilerisë në Trepçali, sulmoi forcat armike në Kutllovë⁹⁵, ku ishin pozicionuar shumë forca të Brigadës 125 të Ushtrisë Jugosllave⁹⁶, nga Llanaku i Pasomës sulmoi Kazermën e UJ-së në Bajër të Mitrovicës⁹⁷, kurse nga Melenica, Batalioni III, në krye me Hasan Preten-

⁹¹ Miftar Kurti, Vrojtme historike, Faik Konica, Prishtinë, 2017, f. 9-29

⁹² Gani N. Lahu, Rrezet e lirisë, Vushtri, 2023.

⁹³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Kosova në vështrim i shkurtër enciklopedik, Tiranë, 1999.

⁹⁴ Der Spiegel, 4 prill 1999; El Pais, 21 prill 1999.

⁹⁵ AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandanti i lirisë”, Agim Ferati për Shemi Ahmetin, 13. 10. 2010.

⁹⁶ Fond za humanitarno pravo, Dosije: 125. motorizovana brigada Vojske Jugoslavije (<https://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/10/Dosije-125.pdf>, qasja e fundit 23. 08. 2025)

⁹⁷ AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandanti i lirisë”, Agim Ferati për Shemi Ahmetin, 13. 10. 2010.

in, sulmoi stacionin policor dhe Punktin në Trepçë. Ky veprim i koordinuar i këtyre njërive i shkaktoi humbje të konsiderueshme armikut. Atë ditë, në fshatin Galicë, ra dëshmori i parë i Njësisë Speciale, Selim Bislimi nga Prishtina, dhe Sabedin Prekazi i Brigadës 142, kurse u plagosën 8 të tjerë⁹⁸. Si rezultat i humbjeve të pësuar, forcat serbe u detyruan ta ngadalësojnë Operacionin “Patkoi” në atë zonë, por disa orë pas sulmit të njërive të sipërpërmendura, forcat serbe hodhën granata dhe bombarduan Tregun e pemëve dhe perimeve në Mitrovicë e Podujevë. Në Mitrovicë mbetën të vrarë 7 civilë shqiptarë dhe mbi 100 të tjerë u plagosën⁹⁹. Për këtë sulm kanë shkruar ndër të tjera edhe gazetata prestigjioze botërore si amerikania “The New York Times” dhe britanikja “The Guardian”.¹⁰⁰

Më 21 mars 1999, Operacioni “Patkoi” u shtri edhe në Shalën e Bajgorës. Që nga 21 marsi e deri më 30 prill 1999, pothuajse për asnjë çast nuk pushuan sulmet mbi pozicionet e UÇK-së me artileri, këmbësori dhe me aeroplanë luftarakë. Për rreth 40 ditë me radhë, komandanti Shemsi Ahmeti qëndroi në ballë të luftës në vijën frontale: Trepçali-Shkëmbi i Bletës-Melenicë-Lagja e Cenajve-Majdan. Duke iu falënderuar strategjisë së tij, të komandantëve të tjerë dhe ushtarëve, Shala u kthye në një kala të pamposhtur ose, siç thotë poeti Jakup Ceraja, në Krujë Skënderbegiane, kurse komandant Shemin, poeti Jakup Ceraja e krahason me Vrana Kontin (Kont Uranin).¹⁰¹

Forcat armike, duke e ditur se marrja e pozicioneve të UÇK-së në Trepçali dhe depërtimi në Shalë përmes magjistrales Mitrovicë-Podujevë, ishte i pamundur, e ndërruan taktikën. Në kuadër të ndërrimit të taktikës shtuan numrin e forcave, njësiteve dhe pajisjeve, si dhe intensifikuan sulmet me këmbësori dhe artileri nga Zherovnica e Zveçani si dhe nga fshatrat Boletin, Zhazhë e Rahovë. Nga 21 marsi 1999, në kuadër të Operacionit “Patkoi”, forcat serbe e

⁹⁸ Ushtarët e plagosur ishin: Fuad Berani, Bekim Islami, Nuhi Bislimi, Ramadan Tahiri, Arsim Musa, Rrahman Kelmendi (141), Vedat Hyseni dhe Shaqir Shaqiri (142) (shih Lista e dëshmorëve dhe të plagosurve të ZOSH, TMK-ZIVM, Sektori Ushtarako-Civil, Mitrovicë, 2001).

⁹⁹ Koha ditore, 14. 03. 1999.

¹⁰⁰ Carlotta Gall, “Bombs Kill 6 in Kosovo Markets As Leaders Depart for Paris Talks”, Neë York Times, March 14, 1999, Section 1, Page 1 (<https://www.nytimes.com/1999/03/14/world/bombs-kill-6-in-kosovo-markets-as-leaders-depart-for-paris-talks.html>, qasja 18.02.2022); Chris Bird, “Bombs kill six in Kosovo”, The Guardian, Sun 14 Mar 1999 00.23 GMT (<https://www.theguardian.com/world/1999/mar/14/theobserver1>, qasja 18. 02. 2022)

¹⁰¹ Jakup Ceraja, Baladë lufte, Rilindja, Prishtinë, 1999.

jugosllave u përforcuan vazhdimisht me forca nga pjesa veriore në Mitrovicë me rrethinë¹⁰². Në Betejën e Trepçalive kishte një disproporcion të madh mes palëve armike, si në personel ashtu edhe në armatim e pajisje tjera. Forcat armike, në këtë betejë, ishin vënë në pozita sulmuese dhe kishin avantazh, si në trupa, ashtu edhe në pajisje (teknikë luftarake). Njësia Speciale dhe e Artilerisë e UÇK-së kishin numër shumë më të vogël ushtarësh, municion të pamjaftueshëm, kishin teknikë ushtarake shumë më pak, dhe ishin në pozicione mbrojtëse. Edhe pse Njësia Speciale dhe ajo e Artilerisë posedonin armatim modest dhe shumë më të pakët se armiku¹⁰³, forcat armike nuk patën sukses të depërtojnë në pozicionet e UÇK-së, pavarësisht se posedonin dhe sulmonin me armatim kalibrash të ndryshëm¹⁰⁴, pavarësisht se sulmonin me njësi të formatit të batalionit dhe me njësi të specializuar të Brigadave 211, 37 dhe 125 nga Trepça, Kutllovci, Rahova, Boletini, Zveçani dhe, nga Llapi, nga ana lindore, me raketa¹⁰⁵. Armiku sulmoi gjithashtu edhe me aviacion, siç ndodhi më 2 prill 1999, në shkollën e Bajgorës dhe në periferi të fshatit Bare të Shalës së Bajgorës¹⁰⁶. Mirëpo, morali i lartë dhe guximi, terreni dhe pozita gjeografike ishin të favorshme për UÇK-në. Duke i pasur parasysh të gjitha këto, magjistranja dhe Kodra e Trepçalive, deri më 30 prill 1999, ishin bërë të pakalueshme për armikun për shkak të rezistencës së madhe nga Njësia Speciale dhe Njësiti i Artilerisë në krye me komandant Shemin. Rrjedhimisht, edhe depërtimi i forcave armike në Shalë, pavarësisht formatit të Operacionit “Patkoi”, ishin vështirësuar shumë, ishte bërë i pamundur.

Për shkak të konfiguracionit të terrenit në Kodrën e Trepçalive, rregullimit siç duhet të kanaleve pozicione e bunkerëve, dhe për shkak të shkathtësisë

¹⁰² Ditari Operativ i Brigadës 141 “Mehë Uka”.

¹⁰³ Lloji i armatimit që posedonin njësitë e UÇK-së: bomba dore, automatikë, gjysmëautomatikë, snajper jugosllav, mitralozë PM-84, PKT, M-48, nitroglicerinë (top dore), snajper 12.5, osa, bazuka, mortaja krahu (150-tëshe dhe 500-ndëshe); minahedhës: 120mm, 82mm dhe 60mm, top pa dridhje e kundërajror-12.7 (Miftar Kurti, “Krimet e forcave serbe në Komunën e Mitrovicës” 1998-1999, *Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2024, f. 447-468)

¹⁰⁴ Lloji i armatimit: mitralozë të rëndë, praga, autoblanda, tanke, raketahedhës e raketa tok-tok (Po aty).

¹⁰⁵ Miftar Kurti, “Krimet e forcave serbe në Komunën e Mitrovicës” 1998-1999, *Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2024, f. 447-468.

¹⁰⁶ Goran Janičević, “Како је Војска Југославије бомбардовала ОВК 1999. Године”, Извор: РТС, недеља, 27.03.2016, 13:30 -> 15:13 (<https://www.rts.rs/vesti/drustvo/2259923/kako-je-vojska-jugoslavije-bombardovala-ovk-1999-godine.html>, qasja e fundit 02. 08. 2025).

së ushtarëve, përveç një të plagosuri, UÇK nuk pati humbje të tjera në këtë betejë. Kjo ishte meritë kryesore e Komandant Shemit, i cili tregoi shkathëtesinë e tij, e dëshmoi veten me strategjinë e tij, qëndroi pranë ushtarëve dhe i koordinoi punët me komandën e Brigadës dhe njësitet vartëse të saj në terren. Ai ishte shumë i kujdesshëm dhe i përqendruar në kryerjen e detyrave. Asgjë nuk i linte rastit. Në të njëjtën kohë aplikonte dy-tri forma të luftës. Një pjesë të ushtarëve të Njësisë Speciale i angazhoi të vepronin me grupe të vogla në brendi të pozicioneve të armikut, një pjesë të qëndronin në pozicione në vijën frontale dhe, pjesën tjetër e angazhoi të vepronin me minahedhës (artileri) kur intensiteti i luftimeve ishte i lartë. Ai sulmonte dhe mbrohej, mbrohej duke sulmuar. Çdo herë ishte i gatshëm t'u ofronte ndihmë me ushtarë dhe mënyra tjera njësiteve të tjera që vepronin në Melenicë, ku armiku sulmonte zonën e përgjegjësisë së Batalionit III. Paralelisht me këto, ai mori masat e nevojshme për një funksionim sa më të mirë të Kazermës në Bare. Se në atë kazermë funksionoi çdo gjë, dëshmon fakti se kur filloi largimi i dhunshëm i popullatës civile nga qyteti i Mitrovicës, Vushtrisë dhe nga rajoni i Llapit në drejtim të Shalës (24 mars-prill 1999), pothuajse as edhe një qytetar i vetëm nuk kaloi nga kazerma e Bares dhe nëpër magjistralen Bare-Kaçanoll, pa i furnizuar me bukë, ujë dhe ndihma të tjera në dispozicion.

Beteja e Rahovës dhe sulmi në bazën e Ushtrisë Jugosllave në Kutllovc (6, 21 dhe 22 prill 1999)

Në pamundësi për të depërtuar në pozicionet luftarake në brendësi të Shalës së Bajgorës përmes magjistrales, përmes Kodrës së Trepçalive dhe rrugës Trepçë-Melenicë, për shkak të rezistencës së fortë të ushtarëve të Njësisë Speciale, të Njësitit të Artilerisë dhe të Batalionit III, atëherë forcat armike e zgjeruan vijën e sulmit frontal në drejtim të Rahovës¹⁰⁷, Zhazhës¹⁰⁸, Vllahisë¹⁰⁹, Zjaçës¹¹⁰ dhe Magjerës¹¹¹. Operacioni “Patkoi”, të cilin, një zyrtar i lartë ushtarak i NATO-s e quan “fushatë ushtarake të planifikuar, të paramenduar dhe të ekzekutuar me përpikëri”, tashmë ishte gjithëpërfshirës në pjesën veriore të Kosovës¹¹². Sulmet vinin sidomos nga Zveçani dhe Zherovnica. Ar-

¹⁰⁷ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës...*, f. 104, 105.

¹⁰⁸ Po aty, f. 167, 168.

¹⁰⁹ Po aty, f. 131-133

¹¹⁰ Aty, f.133, 134.

¹¹¹ Aty, f. 88, 89.

¹¹² Jeffrey Smithë. Drozdiak, “La meticolosa planificación de la Operación

miku, të njëjtën kohë dislokonte forca të shumta në fshatin Rahovë dhe të njëjtën kohë sulmonte nga ana perëndimore me artileri në Trepçali e Melenicë. Duke i parë lëvizjet e armikut nga pjesa veriore në drejtim të Rahovës dhe nga Rahova në drejtim të Lagjes Cenaj dhe Melenicës, komandant Shemi jep idenë, merr iniciativë dhe bën përgatitjet e nevojshme për të sulmuar forcat armike në Rahovë. Ideja e tij ishte përkrahur edhe nga Komanda e Brigadës. Kështu, pas përgatitjeve të nevojshme, më 6 prill 1999 sulmohen forcat serbe të pozicionuara në Rahovë. Sulme mbi Rahovë kishte pasur edhe më parë, por ai i mesnatës së 5-6 prillit ishte sulm shumë më i ashpër. Në këtë betejë morën pjesë komandanti Shemi Ahmeti me Njësinë Speciale, komandanti i ZOSH, Rrahman Rama, i Brigadës 141, Hysni Ahmeti, ushtarë nga njësite të tjera të Brigadës (Batalioni I dhe III) dhe një ushtar i ZOLL (B. Behluli). Luftimet filluan rreth mesnatës së 5-6 prillit dhe zgjatën deri në mëngjes. Humbje në këtë betejë kishte nga të dyja anët. Supozohet se 6 ushtarë të armikut mbetën të vrarë, disa të tjerë u plagosën, një tank u dëmtua, u shkatërrua një autobлиндë dhe një pragë. UÇK-ja humbi ushtarin e Batalionit III, Hajrush Sinani, kurse u plagos komandanti i Togës III të Njësitit Special, Ali Berisha. Sulmi kundër forcave serbe në Rahovë e vonoi shtrirjen e Operacionit “Patkoi” të forcave serbe nga pjesa perëndimore e Lagjes Cenaj, kodrës së Majdanit, fshatit Melenicë dhe fshatrave më të thella në Shalën e Bajgorës.¹¹³

Për shkak të luftimeve pothuajse të përditshme, njësitë të UÇK-së po u pakësohej numri i municionit për armët në dispozicion. Linjat e furnizimit, që kishin funksionuar deri atëherë, po ndërpriteshin. Mundësia e vetme ishte marrja e armatimit dhe municionit gjatë luftimeve nëpër fushëbeteja kundër forcave serbe. Sulmi dhe futja në bazën ushtarake serbe në Kutllovc¹¹⁴

Herradura”, El Pais, 21 Abr 1999 - 00:00 CEST (https://elpais.com/diario/1999/04/21/internacional/924645605_850215.html, 08. 06. 2022).

¹¹³ Ushtarët e UÇK-së posedonin këtë lloj armatimi: AK-47, gjysmëautomatik, mitrolozë, (PM-84), zola e mortaja krahu, kurse armiku u kundërvu me mitralozë të rëndë, gulinovë (12.7), praga, tanke dhe me minahedhës nga Rahova, Trepça e Kodra e Kutllovcit. (Shih Liridon Llozani, “Kreshnikët e Shalës së Bajgorës”, Dokumentar, RTV Dukagjini, 17 Shkurt, 2024, 13:40 (<https://www.youtube.com/watch?v=V1-aivëca4Q>, qasja e fundit 23. 08. 2025); Avdush Canaj, “Pesë Dëshmorët e familjes Musa”, Dokumentar, RTK, prill 2016. (<https://www.youtube.com/watch?v=QRjHQGrDLco>, qasja e fundit 23.08.2025); Dokumentar për jetën dhe veprën e Dëshmorit Rustem Hyseni (Historian), producent Armond Morina, regjia dhe montazhi Blerta Basholli, Morina Films, qershor 2012 (<https://www.youtube.com/watch?v=sV-Vxvuyi1Y>, qasja e fundit 23. 05. 2025); *Rustem Hyseni- Historiani (1973-1999)*, Ditar lufte, revista “Fjalë e valë”, Mitrovicë, 2002, f. 80-81).

¹¹⁴ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës...*, f. 82.

kishte këtë qëllim. Ky ishte një veprim tjetër luftarak i domosdoshëm dhe me shumë rëndësi në të cilin mori pjesë komandanti Shemsi Ahmeti. Sulmi kryhet më 21 dhe 22 prill 1999, fillimisht nga komandantët Shemsi Ahmeti e Ajet Bajrami me ushtarët e Njësiteve të tyre, kurse më vonë edhe nga komandanti i Brigadës, Hysni Ahmeti, dhe i ZOSH-it, Rahman Rama. Në këtë sulm nuk pati as të vranë dhe as të plagosur, sepse forcat serbe ishin detyruar të largoheshin nga baza e tyre nga frika e sulmit të UÇK-së dhe nga frika e bombardimeve nga NATO-ja. Se ushtria serbe (Jugosllave-M.K.) i frikësohej UÇK-së e ka thënë edhe gjenerali Wesley Clark - ish Komandant Suprem i Forcave Aleate për Evropë (SACEUR) gjatë Operacionit “Forca Aleate” (24 mars-20 qershor 1999), më 17 nëntor 2025, gjatë dëshmisë së tij në Dhomat e Specializuara në Hagë, në mbrojtje të krerëve të UÇK-së¹¹⁵. UÇK-ja arriti suksesin e synuar, sepse nga ajo bazë ushtarake e UJ-së mori një sasi të konsiderueshme municioni, por edhe armatimi.¹¹⁶ Me atë rast, komandanti Shemsi Ahmeti ia vuri zjarrin bazës ushtarake në Kutllovc.

Beteja e Majdanit (19-26 prill 1999) dhe rënia heroike e komandantit

Luftë e ashpër frontale në Shalën e Bajgorës u zhvillua në periudhën 21 mars-30 prill 1999, përgjatë vijës frontale Trepçali-Gradina-Melenicë-Prenten-Majdan, mirëpo intensiteti i luftimeve arriti kulmin në Majdan.

Majdani është një kodër me lartësi mbidetare 1260 metra, gjendet rreth 200-300 metra mbi Minierën “Trepça” në Stantërg, e cila lidhë Lagjen Cenaj të Stantërgut dhe fshatrat Rahovë, Vllahi, Zjaçë dhe Melenicë të Shalës së Bajgorës.¹¹⁷ Është rreth 1500 metra vijë ajrore nga fshati Boletin, kurse përballë ka Kodrën e Kutllovcit, ku ishte baza ushtarake e Ushtrisë Jugosllave, në vijë ajrore afërsisht si nga Boletini. Në Kodrën e Majdanit u zhvillua një betejë e përgjakshme mes Njësisë Speciale, Batalionit III dhe Njësisë për Intervenime të Shpejta, në një rën të anë, dhe njësisë të Brigadave 125, 211 dhe 37 të Ushtrisë Jugosllave, si dhe forcave speciale të PJP-së dhe SAJ-it anë tjetër.

¹¹⁵ TV Klan Kosova, 17.11.2025

¹¹⁶ *Ky lloj armatimi dhe municioni u mor nga Kazerma e Kutllovcit: 21 sëndukë (arka) fishekë të tipit 7.62, përkatësisht 26460 copë fishekë; 900 copë fishekë të armës 12.7; 1 PM M-72 me 56340 copë fishekë; 105 copë të kalibrit 7.9; 5 arka Mina TT; 5 arka Mina TK; 6 predha të mina hedhësit 82 mm; MRUD-4 copë; BRS-12 copë; 116 bomba dore; 5 copë mina PTK etj.* (Gjeneral Zymer Halimi-Besi, Shënime nga fletorja, 21-22 prill 1999).

¹¹⁷ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës...*, f. 88, 89, 104, 105, 131-134, 167 dhe 168.

Beteja e Majdanit mund të thuhet se ishte kulmi i betejave të zhvilluara, sidomos në vitin 1999, në zonën e përgjegjesisë të ZOSH. Barrën kryesore në këtë betejë e bartën komandantët Shemsi Ahmeti me Njësinë Speciale, Rexhep Suma nga Njësia për Intervenime të Shpejta dhe Hasan Preteni nga Batalioni III. Në zonën e përgjegjesisë të Batalionit III po zhvilloheshin luftimet. Kjo betejë ishte vazhdim i luftimeve në vijën frontale Cërnavër-Trepçali-Gradina dhe Melenicë. Beteja ka filluar më 15 prill 1999 dhe ka zgjatur deri në mesnatën e 26-27 prillit 1999, mirëpo për nga intensiteti i luftimeve veçohet periudha kohore 19-26 prill 1999. Armiku, në këtë betejë, në kuadër të Operacionit “Patkoi”, nga pjesa veriore e Kosovës kishte të angazhuar një numër shumë të madh të këmbësorisë (policë, paramilitarë, ushtarë të rregullt, njësi speciale) shoqëruar më artilerinë e rëndë. Një nga synimet kryesore të armikut ishte marrja e Kodrës së Majdanit, sepse ajo ishte pikë strategjike, pasi nga ajo kodër mund ta kontrollonte më shumë se gjysmën e Shalës.¹¹⁸

Një nga karakteristikat e veçanta të kësaj beteje ishte fakti se luftimet mes palëve u zhvilluan me sulme e kundërsulme të shpejta. Armiku ishte në pozicione sulmuese, kurse UÇK-ja në pozicione mbrojtëse. Pozicionet mbrojtëse të UÇK-së ishin në formën e shkronjës L. Vija vertikale shënon Kodrën e malin e Majdanit, me pikë të nisjes Lagjen Cenaj, e cila shtrihej deri në maje të kodrës. Vija horizontale ishte rreth 50-60 metra nën rrugën Melenicë-Cenaj, dhe me shtrirje rreth 200 metra mbi Minierën “Trepça” në Stantërg, në anën lindore të Lagjes Cenaj. Kulla, mes Lagjes Cenaj të Stantërgut dhe Lagjes Preteni të Melenicës, ishte pika përbashkuese e vijave horizontale dhe vertikale. Forcat serbe ishin vendosur në pozicione sulmuese në perëndim të Lagjes Cenaj, te Varrezat e Lagjes, te Miniera “Trepça”, dhe në fshatin Rahovë, por perimetri i pozicioneve sulmuese të armikut shtrihej deri në Boletin, Zhazhë e Vllahi. Nga data 15-18 prill, të dy palët u fortifikuan në pozicione, kurse luftimet ishin të një intensiteti të ulët. Kjo betejë u zhvillua në tri faza. Faza e parë e betejës zgjati nga data 19-21 prill. Luftimet më të ashpra u zhvilluan në Lagjen Cenaj, në Kullë, dhe përgjatë Kodrës së Majdanit. Forcat armike, gjatë atyre ditëve, përveç plagosjes së ushtarit të Njesisë Speciale, Hamzë Behrami, nuk arritën t’i shkaktonin humbje të tjera UÇK-së, por as nuk arritën të lëvizin asnjë hap para në asnjë pozicion luftarak në zonën e përgjegjesisë së Brigadës. Në fazën e dytë të betejës (22-24 prill),

¹¹⁸ Miftar Kurti, “Krimet e forcave serbe në Komunën e Mitrovicës” 1998-1999, *Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek.XIX-XX*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2024, f. 447-468.

edhe pse u shtua intensiteti i luftimeve, forcat serbe u zmbrajsën me sukses, sepse në momentin kur po përpqeshin të futeshin tinëzisht në pozicionet e UÇK-së, në formë pyke, mes Lagjes Cenaj të Stantërgut dhe Lagjes Preteni të Melenicës, më 24 prill, Rexhep Suma në krye të grupit të ushtarëve Arsim Muzaqi, Faruk Beqiri dhe Bajram Peci, me një kundërsulm i detyruan të tërhiqen nga pozicioni ku synonin të depërtonin. Faza e tretë dhe finale e betejës zgjati nga orët e hershme të mëngjesit të datës 25 deri në mesin e natës së 26-27 prillit. Proporcioni i forcave në këtë fazë dallonte shumë. Përderisa UÇK-ja, që nga fillimi i betejës, asnjëherë nuk pati mundësi që në luftime të fuste ushtarë më shumë se formatin e një toge, armiku operonte me batalione të disa brigadave të UJ-së dhe me forca të PJP-së dhe SAJ-it. Gjatë luftimeve të ashpra, diku rreth mesditës, më 25 prill, plagoset rëndë ushtari i Njësisë Speciale dhe studenti i Fakultetit Ekonomik, Faruk Beqiri, me ç'rast forcat serbe arritën të depërtojnë dhe ta marrin pozicionin ku ai ishte me dy bashkëluftëtarët e tij. Kjo ndodhi derisa bashkëluftëtarët¹¹⁹ po e tërhiqnin të plagosurin Faruk Beqiri. Për pasojë, një pjesë e Njësisë Speciale u rrethua nga forcat e armikut. Pas kërkesës së komandantit Shemsi Ahmeti, dërguar komandantit të Brigadës 141 për të sjellë disa përforcime, gjendja ndryshoi. Ardhja në ndihmë e komandantit të Brigadës, Hysni Ahmeti, me bashkëluftëtarë nga Shtabi i Brigadës, e ndryshoi rrjedhën e betejës; pozicionet u rikthyen, por gjatë luftimeve, në përpjekje për t'i kthyer pozicionet, u plagos rëndë komandanti i Njësisë për Intervenime të Shpejta, Rexhep Suma.¹²⁰

Ngase Ushtria Jugosllave, me Operacionin "Patkoi", po e shtonte vazhdimisht numrin e forcave dhe pajisjeve, si dhe po e zgjeronte perimetrin e veprimit sulmues nga Miniera "Trepça" në Stantërg dhe nga fshatrat Boletin, Zhazhë, Rahovë dhe Vllahi¹²¹, rreth mesditës së 26 prillit, në malin e Majdanit, në pozicionet luftarake, pa lëvizur asnjë hap prapa, bien heroikisht katër ushtarë të UÇK-së: absolventi i Fakultetit Filozofik-Departamenti i Historisë, Rustem Hyseni (Njësia Speciale), me bashkëluftëtarët e Batalionit III: Ahmet Haxha, Xhemajl Haxha dhe Asllan Cimili, kurse në Kullë u plagos rëndë Bajram Peci.¹²²

¹¹⁹ Fatmir Peci dhe Miftar Kurti.

¹²⁰ Dokumentar për jetën dhe veprën e Dëshmorit Rustem Hyseni (Historian), producent Armond Morina, regjia dhe montazhi Blerta Basholli, Morina Films, qershor 2012 (<https://www.youtube.com/watch?v=sV-Vxvuyi1Y>, qasja e fundit 23. 05. 2025).

¹²¹ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës...*, f. 88, 89, 104, 105, 131-134, 167 dhe 168.

¹²² Dokumentar për jetën dhe veprën e Dëshmorit Rustem Hyseni (Historian), producent

Në përpjekje për t'i mbajtur pozicionet që kishin nën kontroll, në përpjekje për t'i kthyer pozicionet ku kishin rënë katër ushtarët në fjalë, dhe në përpjekje për t'i tërhequr trupat e katër bashkëlufëtareve, nga perëndimi i diellit e deri rreth orës 23:00, komandant Shemi me Njësinë e tij zhvilloi luftë heroike me betimin “i gjallë nuk kthehem në kazermën e Bares pa i tërhequr trupat e bashkëlufëtareve, pa i kthyer pozicionet atje dhe pa e marrë nën kontroll Kodrën e Majdanit”. Në prag të muzgut, komandanti Shemi Ahmeti e ndau Njësinë Speciale në dy grupe. Grupi i parë, i komanduar nga Shemi Ahmeti dhe i përbërë prej 14 ushtarëve¹²³, pasi ra muzgu sulmoi forcat armike frontalisht duke u ngjitur përpjetë Kodrës së Majdanit, ndërsa Grupi i dytë, i cili komandohej nga Sabri Haziri¹²⁴, mori urdhër t'i sulmonte forcat armike nga Vllahia.¹²⁵ Pas rënies në pritë, Grupi i dytë detyrohet të tërhiqet në pozicion tjetër. Sulmi i Grupit të komandantit Shemi ishte i shpejtë. Luftimet zhvillohen lis më lis, gur më gurë, shkëmb me shkëmb e gjoks më gjoks. Hap pas hapi, në përpjekje për ta marrë Kodrën e Majdanit, komandant Shemi me grupin e tij përparoi mirë, derisa arriti afër një masivi shkëmbor, gati në krye të majës së Majdanit. Pozicionimi i forcave armike në anën e epërme, pengesa natyrore (masivi shkëmbor) dhe konfiguracioni i terrenit shumë i papërshtatshëm, imponoi dhe përqendroi luftimet në të dy anët e masivit shkëmbor, ku lufta, për shkak të afërsisë zhvillohej dhe me nitro-glicerinë (to dore), madje edhe me bomba dore. Siç rrëfen njëri nga pjesëmarrësit e asaj beteje, Bahri Hyseni, lufta ishte aq e rreptë sa plumbat e ushtarëve të Njësisë Speciale dhe plumbat e armëve të armikut, rrokeshin me njëri-tjetrin.¹²⁶ Nga

Armond Morina, regjia dhe montazhi Blerta Basholli, Morina Films, qershor 2012 (<https://www.youtube.com/watch?v=sV-Vxvuyi1Y>, qasja e fundit 23. 05. 2025).

¹²³Grupi kishte këtë përbërje: Shemi Ahmeti, Arsim Muzaqi, Enver Musa, Ismail Istrefi, Eset Ibishi, Miftar Kurti, Bahri Hyseni, Basri Fazliu, Lutfi Bunjaku, Ilaz Berisha, Mustafë Ibishi, Haki Istrefi, Musli Musa dhe Basri Zeneli (shih Liridon Llozani, “Kreshnikët e Shalës së Bajgorës”, Dokumentar, RTV Dukagjini, 17 Shkurt, 2024, 13:40 (<https://www.youtube.com/watch?v=V1-aivëca4Q>, qasja e fundit 23. 08. 2025)).

¹²⁴Kishte këtë përbërje: Sabri Haziri, Ferit Preteni, Baki Peci, Sedat Ferati dhe Nuhi Sejdiu (shih Liridon Llozani, “Kreshnikët e Shalës së Bajgorës”, Dokumentar, RTVDukagjini, 17 Shkurt, 2024, 13:40 (<https://www.youtube.com/watch?v=V1-aivwca4Q>, qasja e fundit 23. 08. 2025)).

¹²⁵Liridon Llozani, “Kreshnikët e Shalës së Bajgorës”, Dokumentar, RTV Dukagjini, 17 Shkurt, 2024, 13:40 (<https://www.youtube.com/watch?v=V1-aivwca4Q>, qasja e fundit 23. 08. 2025); Basri Fazliu, Shënim, 15. 04. 2004.

¹²⁶Liridon Llozani, “Kreshnikët e Shalës së Bajgorës”, Dokumentar, RTV Dukagjini, 17 Shkurt, 2024, 13:40 (<https://www.youtube.com/watch?v=V1-aivwca4Q>, qasja e fundit 23. 08. 2025)).

hedhja e bombave nga forcat serbe në pozicionet luftarake të UÇK-së, plagoset Mustafë Ibishi, të cilin me urdhër të komandant Shemit e tërhoqën nga pozicioni luftarak Haki Istrefi dhe Musli Musa. Disa bomba dore u hodhën në pozicionet e armikut nga ushtari Enver Musa-Divi, kurse komandant Shemi sulmonte me nitro-glicerinë. Bomba e Enver Musës, sulmi me nitroglicerinë i komandant Shemit dhe me mitraloza nga Eset Ibishi, Enver Musa dhe Bahri Hyseni, iu shkaktuan humbje të konsiderueshme forcave armike. Mirëpo, pavarësisht humbjeve, pavarësisht se luftimet po zgjasnin, forcat serbe nuk u tërhoqën. Vazhdimisht bënë zëvendësimin e forcave, i përforconin radhët e tyre me forca të reja, me armatim dhe municion të mjaftueshëm dhe shumë më të avancuar.

Nga 14 ushtarët e Grupit të komandant Shemit që nisën sulmin, pas plagosjes së Mustafë Ibishit, të cilin e tërhoqën dy bashkëluftëtarët e tij, nga ky grup në pozicione mbetën vetëm 11 ushtarë. Kurse, forcat serbe, sipas disa të dhënave, atë natë, në Betejën e Majdanit, kishin angazhuar një batalion me mbi 300 ushtarë. Me këtë disproporcion forcash, mundësia që të kalohej masivi shkëmbor pa pasoja tragjike ishte e vogël për disa arsye. E para, lufta zhvillohej natën dhe në një territor shumë të papërshtatshëm. E dyta, numri i forcave të armikut ishte shumëfish më i madh se numri i ushtarëve të Njësisë Speciale; e treta, forcat armike ishin pozicionuar shumë mirë, ishin në anën e epërme të masivit shkëmbor; e katërta, armiku kishte armatim shumë funksional dhe municion të bollshëm. Para një situatë të tillë gozhduese, komandanti mori masat e nevojshme që të sulmonte armikun nga krahu i djathtë (ana lindore e Majdanit). Pasi u bënë konsultimet e nevojshme, çdo ushtar mori detyra të caktuara. Në sulmin e fundit, ushtarët e Njësisë Speciale avancuan disa metra nga ana e djathtë e masivit shkëmbor, duke iu ofruar edhe më shumë armikut. Kur komandanti dha shenjë për sulm përfundimtar, ora shënoi rreth 23:10-23:30 e natës.¹²⁷ Ishte ora kur beteja mori epilogun.¹²⁸ Ishte natë; në shumicën e kohës qielli ishte i mbuluar me re, mes të cilave herë-herë depërtonin rreze hëne. Atje, atë natë, në anën e djathtë, në pjesën lindore të Kodrës së Majdanit, gati në majë të Kodrës, luftimet shënuan shkallën më të lartë të intensitetit. Kur Grupi luftarak i komandantit Shemi Ahmeti iu afrua

¹²⁷ Liridon Llozani, “Kreshnikët e Shalës së Bajgorës”, Dokumentar, RTV Dukagjini, 17 Shkurt, 2024, 13:40 (<https://www.youtube.com/watch?v=V1-aivwca4Q>, qasja e fundit 23. 08. 2025).

¹²⁸ Avdush Canaj, “Pesë Dëshmorët e familjes Musa”, Dokumentar, RTK, prill 2016 (<https://www.youtube.com/watch?v=QRjhqGrDLco>, qasja e fundit 23. 08. 2025).

pozicioneve të armikut vetëm disa metra nga ana lindore, rafalët e mitralozave armik qëlluan nga ana e epërme tre djem, tre trima, tre burra. Komandanti Shemsi Ahmeti u qëllua në gjoks nga një afërsi rreth pesë metra, kurse Arsim Muzaqi (ish-kampion i Kosovës në karate) u qëllua në ballë. Që të dy morën rrugën e pavdekësisë. I treti që u qëllua nga mitralozi PM84 i armikut ishte Ismail Istrefi.¹²⁹ Ismail Istrefi¹³⁰ u plagos rëndë në këmbë, duke pësuar frakturë. Pasi forcat armike, të pozicionuara në anën e epërme, dëgjuan zërin e një ushtari të UÇK-së “se u vra komandanti”, duke menduar se shumica e ushtarëve të UÇK-së mbetën të vrarë, ose së paku të plagosur, nga pozicionet mbrojtëse, forcat armike u nisën në kundërsulm në drejtim të pozicioneve të UÇK-së, me synimin dhe shpresën se pas rënies, do të mund të merrej trupi i komandantit, kurse ushtarët e tij të plagosur do të zihen të gjallë. Ishte zjarri i mitralozave të Enver Musës, Eset Ibishit, Bahri Hysenit dhe shokëve të tjerë, që i plandosi ata për dhe. Dilema e radhës se si të shpëtohen pa rënë në dorë trupat e komandant Shemit dhe Arsim Muzaqit, u hoq. Ushtarët e Njësisë Speciale^{131*}, duke shfrytëzuar kundërsulmin për t’i neutralizuar veprimet e armikut, arrijnë t’i marrin dhe t’i tërheqin trupat e komandant Shemit dhe Arsim Muzaqit, të cilët i dërgojnë fillimisht në bazën e UÇK-së të Batalionit të Tretë në Preten, pastaj në Bajgorë, ku të nesërmen varrosen.¹³² Kurse, pas dy orë përpjekjesh, diku rreth orës 1:30 të natës, bashkëluftëtarët¹³³ arritën ta tërheqin edhe të plagosurin tjetër, Ismail Istrefi. Ismail Istrefi, i plagosur shumë rëndë, ishte ushtari i fundit që u tërhoq gjallë nga bashkëluftëtarët nga ajo betejë.¹³⁴

¹²⁹ “Buzëqeshja e fundit”, Film Dokumentar kushtuar Heroit të Kosovës Shemsi Istrefi, skenari dhe regjia Fazli Muharremi, prill 2024 (<https://www.youtube.com/watch?v=XgrvkPAPp6U>, qasja e fundit 23. 08. 2025).

¹³⁰ Ismail Istrefi ishte kthyer në Kosovë nga Anglia në qershor 1998 ku kishte lënë pagën mujore rreth 6000 funta (Bisedë me Ismail Istrefin, Bajgorë, tetor 1998).

¹³¹ Trupat e komandant Shemit dhe Arsim Muzaqit i tërhoqën: Eset Ibishi, Enver Musa, Bahri Hyseni, Basri Fazliu, Ilaz Berisha dhe B.Zeneli (Avdush Canaj, “Pesë Dëshmorët e familjes Musa”, Dokumentar, RTK, prill 2016 (<https://www.youtube.com/watch?v=QRjhgGrDLco>, qasja e fundit 23. 08. 2025).

¹³² Avdush Canaj, “Pesë Dëshmorët e familjes Musa”, Dokumentar, RTK, prill 2016 (<https://www.youtube.com/watch?v=QRjhgGrDLco>, qasja e fundit 23. 08. 2025).

¹³³ Miftar Kurti dhe Lutfi Bunjaku.

¹³⁴ Liridon Llozani, “Kreshnikët e Shalës së Bajgorës”, Dokumentar, RTV Dukagjini, 17 Shkurt, 2024, 13:40 (<https://www.youtube.com/watch?v=V1-aivwca4Q>, qasja e fundit 23.08.2025); Avdush Canaj, “Pesë Dëshmorët e familjes Musa”, Dokumentar, RTK, prill 2016 (<https://www.youtube.com/watch?v=QRjhgGrDLco>, qasja e fundit 23.08.2025);

Përmbledhur me pak fjalë, bilanci i të vrarë dhe të plagosurve në periudhën kohore 19-26 prill 1999, në Betejën e Majdanit, ishte sa heroik po aq edhe tragjik. Nga fillimi e në fund të kësaj beteje ranë heroikisht: ushtaraku profesionist, komandanti i Njësisë Speciale, i Njësisë Artilerisë dhe i Kazermës së Bares, Shemsi Ahmeti, Arsim Muzaqi (kampion i Kosovës në karate), Rrustem Hyseni-Historiani (absolvent në degën e Historisë, me notë mesatare 9.53), Faruk Beqiri (student i Ekonomisë). Të gjithë këta pjesëtarë të Njësisë Speciale. Nga Batalioni III ranë dëshmorë ushtarët trima: Ahmet Haxha, Xhemail Haxha dhe Asllan Cimili. Ndërsa, nga fillimi e deri në fund të betejës u plagosën 7 pjesëtarë të UÇK-së. Edhe numri i të vrarëve dhe të plagosurve të armikut s'do mend se ishte i madh. Sipas një dëshmitareje, grua shqiptare, e cila kishte shtëpinë afër Kinemasë dhe Administratës së Minierës "Trepça", më 27 prill 1999, derisa forcat armike po ktheheshin në Trepçë nga Beteja e Majdanit, kishin deklaruar se vetëm natën mes 26-27 prillit kanë humbur 18 ushtarë. Ky deklaram mbetet në nivel deklarimi përderisa nuk kemi mbështetje dokumentare.

Njësia Speciale dhe Njësi i Artilerisë, që u komanduan nga komandanti Shemsi Ahmeti, nga data 13 mars 1999, kur ra dëshmori i parë i Njësisë Speciale, Selim Bislimi, i dhanë Kosovës 14 dëshmorë¹³⁵ dhe 16 të tjerë u plagosën¹³⁶. Dëshmorët u flijuan në fshatrat rrëzë Qyqavicës, në Betejën e Majdanit, në Betejën e Pretenit, në Betejën e Rahovës, në Kodrën e Vesekovcit, në Kodrën e Birave dhe në Mitrovicë.

Me formimin e Batalionit Gardist të ZOSH (maj 1999), të gjithë pjesëtarët e Njësisë Speciale u bënë pjesë e atij batalioni, komandant i të cilit u emërua Hasan Preteni. Njësia Gardiste, ushtarët e Njësisë për Intervenime të Shpejta dhe të Batalionit III e çliruan Minierën "Trepça" në Stantërg, më 19 qershor 1999. Po atë ditë e vendosën flamurin kombëtar mbi kulmin e stacionit pol-

Dokumentar për jetën dhe veprën e Dëshmorit Rrustem Hyseni (Historian), producent Armond Morina, regjia dhe montazhi Blerta Basholli, Morina Films, qershor 2012 (<https://www.youtube.com/watch?v=sV-Vxvuyi1Y>, qasja e fundit 23. 05. 2025).

¹³⁵ Shemsi Ahmeti, Arsim Muzaqi, Faruk Beqiri, Bajram Musa. Rrustem Hyseni (Historiani), Enver Musa (Divi), Shemsi Istrefi, Selim Bislimi, Nysret Musa, Ferit Preteni, Fehmi Preteni, Musrel Xhemajli-Boletin, Eset Ibishi dhe Hamzë Behrami (Shih TMK-AZIVM, Sektori Ushtarako-Civil, Mitrovicë, 2001).

¹³⁶ Nuhi Bislimi, Bekim Islami, Ramadan Tahiri, Ali Berisha, Bajram Peci, Mustafë Ibishi, Ismail Istrefi, Miftar Kurti, Basri Zeneli, Hamdi Tahiri, Shefqet Begu, Florim Islami, Halil Berisha, Sadat Ferati, Ismet Hajdari, Gani Uka (Shih TMK-AZIVM, Sektori Ushtarako-Civil, Mitrovicë, 2001).

icor në Trepçë, duke shënuar kështu ditën e çlirimit të katër lagjeve të Trepçës dhe Minierën “Trepça” në Stantërg. Në momentin kur ushtarët e këtyre një-sive po niseshin magjistrales në drejtim të Tunelit të Parë dhe Mitrovicës, forcat e KFOR-it francez i ndalojnë dhe nuk i lejojnë të vazhdojnë më tutje, si rezultat i Marrëveshjes së Kumanovës të nënshkruar nga NATO-ja dhe UJ-ja, më 9 qershor 1999, e cila ndalonte çdo mundësi që UÇK-ja të futej në qytete, në këtë rast në Mitrovicë.¹³⁷

Heronjtë, sipas literaturës, veçohen nga njerëzit e zakonshëm për shkak të disa cilësive. Disa nga cilësitë e heronjve konsiderohen se janë: guximi, vendosmëria, dhembshuria, humanizmi, durimi, etj. Shemsi Ahmeti i posedonte të gjitha këto cilësi. Këto cilësi i dëshmoi nëpër betejat më të vështira të luftës dhe të jetës. Sipas Emin Musës, koloneli i FSK-së në pension dhe Ndihmëskomandantit për Çështje Personale në Brigadën 141, Komandanti Shemsi Ahmeti ishte njeri fjalëpak dhe i heshtur, kur fliste, nuk fliste vetëm për të folur, por ishte i vendosur në atë që thoshte. Ai kishte një qëndrim të vendosur, shikim vigjilent dhe të ashpër, ishte i kujdesshëm dhe punëtor shumë i madh. Ishte një trim i pashoq dhe shumë stabil. Ushtrimet që i bënte me njësinë e vet, i pari i demonstronte praktikisht, pastaj i sprovonte ushtarët. I pari ishte edhe në fronte lufte. Komandanti Shemsi Ahmeti ishte një figurë emblematike.¹³⁸ Komandanti i Njësisë për Intervenime të Shpejta, Rexhep Suma, ndër të tjera deklaroi se “në Betejën e Mazhiqit (korrik-15 shtator 1998) e pashë dijen dhe guximin e tij, i pashë ushtarët serbë kah binin për tokë nga snajperi i komandantit Shemsi Ahmeti. Të tillë e pashë edhe në Betejën e Majdanit”¹³⁹. Ramiz Osmani, ish-epor në Brigadën 141 “Mehë Uka”, në fjalën e rastit mbajtur më 27 prill 1999 me rastin e varrimit të komandantit, ndër të tjera thotë se Shemsi Ahmeti tregoi guxim dhe aftësi të shkëlqyera organizative ushtarake. Falë aftësive të tij, komandanti i Brigadës e emëroi komandant të Njësisë Speciale. Eporët dhe ushtarët e tij u mahnitën me aftësitë profesionale, ushtarake si dhe me trimërinë e komandantit Shemsi Ahmeti. Ai ishte forcë për ushtarët e tij e tmerr për armikun. Komanda e tij në beteja

¹³⁷ Military Technical Agreement between the International Security Force (“KFOR”) and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia, 9 June 1999, Basic documents, Updated: 2 August 1999 (<https://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>, qasja e fundit 29. 07. 2024).

¹³⁸ AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandanti i lirisë, Emin Musa kujtime për Shemsi Ahmetin, f. 2.

¹³⁹ AASHK, Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandanti i lirisë, Rexhep Suma për Shemsi Ahmetin, 14 tetor 2010, f. 2-3.

ishte: “Pas meje trima, ta sulmojmë armikun”. Taktika e tij luftarake i ngjante asaj të Skenderbeut: Sulmo në befasi, sulmo aty dhe atëherë kur armiku nuk e pret.¹⁴⁰ Meritat e komandantit Shemsi Ahmeti janë shumë të mëdha.¹⁴¹ Prandaj, jo rastësisht, për komandantin Shemsi Ahmeti, përveç që kanë rrëfyer e shkruar bashkëluftëtarët, kanë shkruar historianë, shkrimtarë e publicistë. Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja, që të dy anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, shkruajnë ndër të tjera se Shemsi Ahmeti ishte luftëtar, ishte organizator i formacioneve të UÇK-së, ushtarak profesionist, formoi njësi ushtarake, ndërmori sulme të suksesshme mbi bazat ushtarake serbe¹⁴². Profesori dhe shkrimtari Emin Kabashi i ka bërë një vlerësim gjithëpërfshirës jetës dhe veprimtarisë së komandantit Shemsi Ahmeti në monografinë “Komandanti i lirisë” kushtuar atij, duke u bazuar në të dhëna të mbledhura në terren nga bashkëluftëtarët, duke shkelur me këmbë çdo pozicion luftarak në Shalë ku ka luftuar komandanti Shemsi Ahmeti. Si rezultat i kësaj pune të madhe dhe profesionale, ai ka mbledhur dëshmi e fakte historike nga bashkëluftëtarët e komandantit Shemsi Ahmeti, disa prej të cilëve i cituam më herët¹⁴³. Monografia “Kalorësi i lirisë” e prof.dr.Emin Kabashit për dëshmorin e lirisë, Shemsi Ahmetin, duke u “vetërrëfyer” nga pozicioni i përtejetës shndërrohet në një manual të luftëtarit të dritës, siç do ta titullonte shëmbëllyeshëm veprën e vet Coehlo, vite më parë, shkruan ndër të tjera redaktori i monografisë, poeti dhe prozatori i njohur, Adem Gashi¹⁴⁴. Në një rast tjetër, poeti dhe shkrimtari i njohur Adem Gashi ka shkruar tekstin e një këngë kushtuar komandant Shemit, të cilën e këndon Shkurte Fejza, nga i cili po shkëpusim këto vargje:

*Që nga Kërshat e Pretenit,
gjer te Maja e Majdanit,
pararojë Shemsi Ahmeti
jep kushtrimin e komandantit.
Me gjuhë flakësh thur kurorë,
sup më sup me Arsimin,*

¹⁴⁰ Ramiz Osmani, Fjalë e mbajtur në emër të Brigadës 141, me rastin e varrimit të komandantit Shemsi Ahmeti dhe bashkëluftëtarit të tij, Arsim Muzaqi, Bajgorë, 27 prill 1999.

¹⁴¹ Riza Haziri, “Shemsi Ahmeti-kampion i heroizmit”, Revista “Fjalë e valë”, Mitrovicë, KL “Lumi i Bardhë”, Mitrovicë, 2004, 180-185.

¹⁴² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar...*, f. 27-28.

¹⁴³ AASHKA, Fondi Emin Kabashi, Dosja “Komandanti i lirisë”.

¹⁴⁴ Emin Kabashi, *Komandanti i lirisë (Dëshmorit të Kombot Shemsi Ahmeti)*, Kopertina e librit, SHB “ERA”, Prishtinë, 2010.

*s'ka forcë, hej, që e ndal trimin.*¹⁴⁵

Luftës heroike të komandantit Shemsi Ahmeti dhe bashkëluftëtarëve të tij, u ka thurur vargje epike, gati si te “Lahuta e Malsisë” e Gjergj Fishtës, profesori universitar, Zenun Gjocaj. Me vargjet e tij, ai e ka himnizuar rolin e komandant Shemit dhe bashkëluftëtarëve të tij. Ai ka shkruar mbi 29 faqe tekst, mbi 590 vargje për heroizimin e tij dhe bashkëluftëtarëve të tij që luftuan në Betejat e Majdanit, Pretenit dhe Melenicës.¹⁴⁶ Për komandantin Shemsi Ahmeti ka shkruar edhe shkrimtari dhe apologjeti Bedri Tahirin në veprën e tij “Fladanët e lirisë”¹⁴⁷. Për komandant Shemin kanë thurur e kënduar këngë këngëtarë e rapsodë, si: *Shkurte Fejza*¹⁴⁸, *Shaqir Cërvadiku*¹⁴⁹, *Gjon Frroku*¹⁵⁰, *Ibish Broja*¹⁵¹, *Vëllezërit Çetaj*¹⁵², *Ganimete Asllani*¹⁵³, *Vëllezërit Bajra*¹⁵⁴, *Vëllezërit Haliti*¹⁵⁵, etj. Kurse piktori akademik, Gani Sadiku, ka bërë portretin e Heroit të Kosovës-Shemsi Ahmeti në një pikturë artistike. Ndërkaq, skulptori shqiptar Momtaz Dhrami ka bërë shtatoren e komandantit Shemsi Ahmeti, e cila është e vendosur në Bulevardin “Shemsi Ahmeti” në Mitrovicë.

Përfundime

Si rezultat i të gjitha këtyre të bëmave të komandantit Shemsi (Arif) Ahmeti, i cilësive të këtij heroit, i veprimtarisë, sakrificës dhe rënies së tij sublimë, jo rastësisht, në vitin 2012, nga Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga, është dekoruar me *Urdhrin “Hero i Kosovës”*. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pas luftës, e ka graduar (post-mortum) me gradën *KOLONEL*. Me emrin e tij janë emërtuar rrugë, bulevarde, shkolla e njësite ushtarake. Batalioni 14 Gardist i Zonës IV të Trupave Mbrojtës të Kosovës në Mitrovicë është emërtuar me emrin e tij. Me em-

¹⁴⁵ Po aty, f. 224.

¹⁴⁶ Zenun Gjocaj, *Krahët e Shqipërisë*, Botues Radio Kosova e Lirë, Prishtinë, 2012, f. 281-299.

¹⁴⁷ Bedri Tahiri, *Flakadanët e lirisë*.

¹⁴⁸ <https://www.youtube.com/watch?v=Optgqma6WKU>, qasja e fundit 23. 05. 2025.

¹⁴⁹ <https://www.youtube.com/watch?v=l6eCM8scu4E>, qasja e fundit 23. 08. 2025.

¹⁵⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=tBd85ryfdZE>, qasja e fundit 23. 08. 2025.

¹⁵¹ <https://www.youtube.com/watch?v=sfl6jhUOC8U>, qasja e fundit 23. 05. 2025.

¹⁵² <https://www.youtube.com/watch?v=xRdHPzvPKH8>, qasja e fundit 23. 08. 2025.

¹⁵³ <https://www.youtube.com/watch?v=5z5FgEFqDZc>, qasja 23. 08. 2025.

¹⁵⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=gyHSTS4GaD8>, qasja e fundit 23. 05. 2025.

¹⁵⁵ <https://m.youtube.com/watch?v=VEHsMM7DBAA>, qasja e fundit 23. 05. 2025.

rin e tij është emërtuar edhe shkolla fillore në fshatin Shupkovc (Mitrovicë). Në Mitrovicë është ngritur *shtatorja* në “Bulevardin Shemsi Ahmeti”. Para shkollës fillore në Shupkovc është ngritur busti. Në fshatin Kodër (ish-Zasellë) është zbuluar pllaka përkujtimore, ndërsa në vendin e rënies së tij po ashtu është vendosur një pllakë përkujtimore. Në Kodrën e Majdanit është ngritur një memorial 9 metra i lartë, me emrin e fotografisë së tij, si dhe të dëshmorëve që ranë në rajonin ku ai komandoi.¹⁵⁶

Pas përfundimit të luftës dhe pas transformimit të UÇK-së në TMK, shumica e ushtarëve të njësiteve që komandoi Shemsi Ahmeti, vazhduan të shërbejnë në Batalionin 14 Gardist “Shemsi Ahmeti” dhe në njësi të tjera të Zonës IV Mbrojtëse, por pati edhe të tillë që kaluan në jetën civile. Një pjesë e tyre sot janë ushtarakë në FSK dhe kryejnë detyra të rëndësishme. Në TMK e FSK, ushtarët e tij janë graduar me grada të ndryshme, nga tetari deri në major. Për kontributin e dhënë gjatë luftës, pjesa dërmuese u shpërblyen me mirënjohje e dekorata nga institucione vendore, shoqata dhe asociacione të tjera, por për fat të keq pati të tillë që u arrestuan, u keqtrajtuat dhe u burgosën nga UNMIK-u. Të gjithë pjesëtarët e Njësisë Speciale, të Njësitit të Artilerisë dhe Kazermës në Bare, të cilat ai i komandoi, gëzojnë statusin e veteranit-luftëtarit të UÇK-së¹⁵⁷.

¹⁵⁶ Liridon Llozani, “Kreshnikët e Shalës së Bajgorës”, Dokumentar, RTVDukagjini, 17 Shkurt, 2024, 13:40 (<https://www.youtube.com/watch?v=V1-aivwca4Q>, qasja e fundit 23. 08. 2025); Avdush Canaj, “Pesë Dëshmorët e familjes Musa”, Dokumentar, RTK, prill 2016 (<https://www.youtube.com/watch?v=QRjhgGrDLco>, qasja e fundit 23. 08. 2025); Dokumentar për jetën dhe veprën e Dëshmorit Rustem Hyseni (Historian), producent Armond Morina, regjia dhe montazhi Blerta Basholli, Morina Films, qershor 2012 (<https://www.youtube.com/watch?v=sV-Vxvuyi1Y>, qasja e fundit 23. 05. 2025).

¹⁵⁷ Pjesëtarët e Njësisë Special që gëzojnë statusin e veteranit luftëtarë: Sabri Haziri, Hajzer Kurti, Shefqet Kurti, Ilaz Berisha, Musli Musa, Rahman Latifi, Bahri Hyseni, Baki Peci, Basri Fazliu, Agron Syla, Lutfi Bunjaku, Shukri Selimi, Nuhi Sejdiu, Ahmedin Musa, Vedat Tahiri, Bejtë Ferizi, Mensur Ferizi, Rustem Bajraktari, Jahir Sejdiu, Rustem Rustemi, Beqir Beqiri, Avdullah Behrami, Sabri Haxholli, Qamil Murseli, Vesel Murseli, Shefqet Ahmeti, Salih Ahmeti, Tahir Isufi, Halil Strana, Naim Ferati, Imer Fejzullahu, Rahman Uka, Latif Hyseni, Besim Istrefi, Sejfi Mustafa, Afrim Imeri, Hamdi Hasani, Zymer Hyseni, Hazir Januzi, Qerim Hetemi, Naim Gashi, Fejzë Ademi. Pjesëtarë të Njësisë Speciale në periudha të caktuara ishin edhe Ismail Istrefi, Haki Istrefi, Behxhet Istrefi, Levent Gara, Mirsad Nimani, Fatmir Peci, Afrim Murseli (Limi), Rahman Kelmendi, Arsim Musa dhe Sylë Gashi.

